

VETERANI

GAZETË PERIODIKE NR.9 (363) SHTATOR 2018 ÇMIMI: 30 LEKË

Kryeredaktor: Halil RAMA ; Zv/Kryeredaktor: Sakip Cami Email: veterani.obvl@yahoo.com / website: www.VETERANIOBVL.ORG

76 VJET MË PARË

RRESHTIMI I SHQIPËRISË NË ANËN E DREJTË TË HISTORISË



Nga Halil Rama FAQE 3

DEKLARATA

FADIL HOXHA, IDEATOR I NDËRTIMIT TË IDENTITETIT KUSHTETUES TË KOSOVËS



FAQE 5

STUDIMI

VITI I SKËNDËRBEUT- MESAZH PËR VLERËSIMIN E TRADITAVE



Nga Xhemal Meçi FAQE 8

DEKLARATA DELUZIONISTE PËR KUFIJTË QË USHQEJNË KAOSIN DHE FRIKËN

Sovraniteti dhe integriteti i Republikës së Kosovës, të pacënueshëm

SHBA nuk e përkrah idenë për shkëmbim territorësh

Nga Bashkim HISARI

Ballkani gjithmonë ka qenë i banuar me kombe dhe grupe etnike të ndryshme që dallohen për nga gjuha, zakonet dhe feja. E kaluara e përgjakshme e popujve të Ballkanin ka ndikuar që shpesh të konsiderohet si "fuqë baruti" i kontinentit të vjetër. Për këtë epitet nuk janë të pafajshëm edhe evropianët dhe superfuqitë e tjera, të cilët për shkak të pozicionit gjeostrategjik të rajonit duke "fikur zjarrin me kasht" kanë komplikuar situatën në këtë gadishull.

Shqiptarët dhe serbët në Ballkan janë dy kombe me një armiqësi shekullore. Mes veti kanë patur, sjellje të vrazhdëta, acarime, urrejtje, zemërim, konflikte edhe përlëshje me armë. Serbët një kohë të gjatë kanë një doktrinë që ka ngjallur tmerr të padurueshëm me përdorimin e terrorit, dhunës monstruoze, masakrave dhe luftës për zhdukjen e kombit shqiptar.

Në kohën kur po afrohet faza përfundimtare e negociatave mes Prishtinës dhe Beogradit, zyrtarët kryesorë të Kosovës, Serbisë dhe ndërkombëtarët po flasin për rridefinimin e kufijve mes Kosovës dhe Serbisë duke përdorur fjalët "shkëmbim territorësh, korrigjim të kufirit, rivendosje të kufive, lëvizje të kufive, ndarje etnike, demarkacion...". Presidenti i Serbisë Aleksandër Vuçiq dëshiron korrigjimin e kufirit në pjesën veriore, kurse ai i Kosovës, HashimThaçi dëshiron të korrigjojë kufirin e Kosovës vetëm në lindje. Kjo faktikisht lë të nënkuptohet bashkimin e Veriut të Kosovës me Serbinë dhe Luginën së Preshevës me Kosovën, për njohjen e pavarësisë së Kosovës.

Presidenti Thaçi lëshoi idenë për korrigjimin e kufijve në mes të Kosovës dhe Serbisë, duke thënë se "nuk ka ndarje tokësore" të Kosovës por, kërkoj bashkimin e Luginës së Preshevës, tri komunave me shumicë shqiptare: Preshevën, Bujanocin dhe Medvegjin që ndodhen në territorin e Jugut të Serbisë.

(Vijon ne faqen 6)

Independent KOSOVA



• Shqiptarët dhe serbët kanë nevojë për paqe të qëndrueshme dhe siguri e jo të luftojnë e të vriten për territore. Kanë nevojë për më shumë rezultate të prekshme politike e më pak fjalë. Jo të rivizatojnë kufijtë, por të ndryshojnë politikat e tyre. Zgjidhja e problemit mund të jetë krijimi e një politike alternative të bazuar në një ekuilibër pragmatik të pakënaqësive, që objektivist ekzistojnë në radhët e shqiptarëve dhe serbëve, me domosdoshmërinë e komunikimit mes tyre dhe mbështetjen e faktorit ndërkombëtar që do të garantojë një tranzicion më të suksesshëm dhe krijojë kushte më të volitshme për antarsim të dy shteteve në BE dhe NATO

FAQE 6-7

PROMOVIMI



UET-PRESS promovon "Zëra nga errësira", Eni Vasili: Jam shokuar dhe përlotur

FAQE 12

HISTORIA

74 vjet më parë u formua Brigada e XXII Sulmuese Partizane e Pezës

FAQE 2

74- VJETORI

Brigada e XXIII Sulmuese Partizane në betejat për liri

FAQE 4

PËRCJELLJA

Këshilli i Bashkisë Memaliaj nderon ish partizxanin e brigades së XIX-t Sulmuese

Jonuz Muharrem Jahaj, "Qytetar Nderi" i Memaliajt

FAQE 9

HOMAZH

IKU NANË XHUMA MALEÇKA!




FAQE 9

PROFIL

DR. LUIGJ BENUSSI, PINJOLLI I PAHARRUAR I NJË SAGE FISNIKËSH

SHPENDI TOPOLLAJ FAQE 10

LIBRI



Hiqmet Gonxhja shkruan për gonxhet e prillit

Sakip Cami FAQE 11

HISTORIA

74 vjet më parë u formua Brigada e XXII Sulmuese Partizane e Pezës

• Urdhërin e krijimit e komunikoi Heroi i Popullit Myslim Peza. Kristo Themelko, anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH, i dorëzoi flamurin e brigadës Sali Verdhës, i cili u caktua komandant i kësaj njësie luftarake

Shtatëdhjetëkatër vjet më parë, më 18 shtator 1944, u formua Brigada XXII Sulmuese e UNÇI Shqiptare, në Pezë të Tiranës. Kjo Brigadë, ashtu si edhe brigadat e tjera, u krijua me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, mbi bazën e katër batalioneve të Grupit Partizan të Pezës, më 18 shtator 1944, në Pezë. Brigada XXII Sulmuese Partizane pati me një efektive fillestar 1236 veta, ndërkohë radhet e saj u shtuan deri sa arriten në 1400 partizanë.

Urdhërin e krijimit e komunikoi Heroi i Popullit Myslim Peza. Kristo Themelko, anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH, i dorëzoi flamurin e brigadës Sali Verdhës, i cili u caktua komandant i kësaj njësie luftarake. Ai i në emër të efektivit u betua para flamurit, se do ta mbanin të papërlyer këtë simbol të brigadës e do ta mbronin po qe nevoja edhe me gjak. Në përberje të efektivit të brigadës, bënin pjesë partizanë dhe kuadro të viteve 1940, 1941, 1942, 1943 etj. që kishin një përvojë të gjatë lufte. Partizanë të vitit 1940 ishin, ish-pjesëtarë të çetës së parë patriotike të Pezës si Shaban Rexha, Skënder Myslim Peza, Dije Myslim Peza, Emin Çelmeta, Fadil Çelmeta, Hamdi Grori, Shaban Durishti, Sherbet Harizi, Selman Grori, Zyber Loshi, Myrteza Karaj, Ymer Kurti, Telha Zgura, Xhevdet Petrela etj. Në brigadë bënin pjesë 34 vajza me në krye Dije Myslim Pezën.

Brigadës iu ngarkua detyra për të pastruar të gjitha çerdhet dhe pikat mbështetëse të armikut në zonat përreth Tiranës, Durrësit, Shijakut, Kavajës, Rrogozhinës, Peqinit etj. detyrë që e kreu me përkushtim dhe nder. në sajë të luftës së saj heroike, të trimërisë e guximit e partizan u shpartalluan forcat nazifashiste e balliste që ishin përqendruar e fortifikuar në afërsi të Shijakut, Arapje, Pjeshkëz, Kuç, Kus, Gjokaj, Kashar e deri në Vorë dhe më 1.10.1944 me një luftë të befasishme dhe të studiuar mirë, çliruan Ndroqin.

Me urdhër të shtabit të Divizionit II me 7 tetor 1944, brigada niset për në Veri ku mori pjesë në luftime kundër nazistëve gjermanë dhe mercenarëve të Gjon Markagjonit, Kol Bib Mirakës tej. Ajo mori pjesë në çlirimin e Mirditës dhe u përlesh me armiqtë në Gziq, të Ura e Fanit, Shpal e Pukë, duke u zhvilluar luftime deri edhe trup me trup.

Në Gziq të Mirditës nazistët e bashkëpunëtorët patën humbje të shumta. Për këtë arsye nazistët kapin e torturojnë dhe pastaj i pushkatojnë 13 veta, pjesëtar të çetës vullnetare territoriale të Mirditës, dogjën 15 shtepi, grabitën gjënë e gjallë dhe bereqetin.



Pas Çlirimit të Mirditës dhe të Pukës brigadën e drejtuan komandant Sali Verdhë, komisar Tonin Jakova, zv/komandant Shaban Rexha, zv/komisar Sadik Bocaaj, sekretar i rinise Iljaz Reka, intendent Rexhep Kollçaku. Më vonë komisar u bë Nimet Ymeri, komandant Rexhep Zuna cili ra dëshmor, dhe e zëvendësoi Neshat Hysi, deri në suprimin e brigadës, më 30.04.1946.

Brigada mori pjesë në çlirimin e Shkodrës ku partizanët e së cilës, së bashku me partizanë të brigadave të tjera dhe të njëjve partizane të Shkodrës, zhvilluan luftime të jashtëzakonshme kundër nazistëve e reaksionarëve të vendit që ishin grumbulluar aty, për t'u nisur jashtë bashkë me nazistët. Batalioni IV i kësaj Brigade, në orën 7.30 të datës 29 nëntor, hyri i pari në qytet. Populli i priti me tufa me lule, me brohoritje entuziaste të papara e me këngë e valle.

Rreth orës 8.30 të kësaj date, nga ballkoni i prefekturës së Shkodrës, zv/komisari i Batalionit IV të kësaj brigade, Irfan Çelkupa përshëndeti popullin e Shkodrës dhe luftëtarët çlirimtarë dhe dha sihariqin e madh se me çlirimin e Shkodrës u çlirua njëherë e përgjithmonë gjithë Shqipëria.

Menjëherë pas çlirimit të Shkodrës, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, më datën 2.12.1944, Brigada kaloi kufirin shtetëror në ndjekje të

armikut dhe duke manifestuar frymën e lartë internacionaliste luftoi për çlirimin vëllezërvë të Malit të Zi, Kosovës e Maqedonisë dhe të popujve të Jugosllavisë.

Më 14. 02.1945, pas shumë luftimesh të ashpra, u be e mundur të çlirohet Vishegradi, për çlirimin e të cilit u zhvilluan 100 dite luftime nga Brigada VIII dhe brigada XXII. Pas këtyre luftimeve me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, brigada u kthye në Kosovë ku zhvilloi luftime të ashpra e të vendosura kundër mbeturinave çetnike. Dhe në janar 1946 Brigada kthehet në Atdhë, në Elbasan, duke përshkruar një rrugë prej 3500 km në një temperaturë që shkonte deri edhe minus 25 gradë Celsius duke çarë dëborën që arrinte deri në 2 m lartësi, veshur keq e me ushqim të pakët, por me idealin e madhe të çlirimit.

Gjate luftimeve brenda dhe jashtë kufirit shtetëror, nga kjo Brigadë ranë dëshmorë 107 partizanë dhe kuadro, mes tyre dhe pionieri 14 vjeçar Heroi i Popullit, Met Hasa dhe mbi 80 partizanë të tjerë u plagosën duke mbeten për tërë jetën invalidë të LANÇ.

26 vjet me radhë po ulërasin e shpifin për LANÇ e për drejtuesit e saj, armiqtë e asaj epopeje të lavdishme. Ata që mbrojnë e etërit e tyre që nuk i mbron dot askush, sepse ata u bashkuan me pushtuesit nazifashistë e luftuan

Brigada e XIX-të Sulmuese

Brigada e XIX-të Sulmuese që u formua më 16 shtator 1944 kishte komandant Andrea Masin, komisar Vango Mitrojorgji, zv/komandant Mehmet Dusha dhe zv/komisar Lefter Kasneci. Në përberjen e saj u fut edhe batalioni "Çamëria".

Brigada u ndërtua mbi bazën e grupit të katërt të Theollogos nga partizanët e batalioneve "Thoma Lulo", "Thanas Ziko" dhe "Lefter Lulo". Më 1 tetor 1944 kaloi në përberjen e Divizionit të II së bashku me brigadën e XII dhe brigadën e XIV.

kundër popullit e partizanëve të tij. E ata që luftojnë kundër popullit të tyre e kanë vendin në koshin e historisë. Shpifjet, intrigat, tentativat për shtrembërimin dhe përmbysjen e historisë së LANÇ, janë turp i botës. LANÇ, ishte dhe mbetet maja e Historisë së Luftërave.

(Marre nga faqja "Veteranët e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare Shqiptare" në facebook)

KONFERENCA

76 vjet më parë - Vendimi më i rëndësishëm i Konferencës së Pezës, krijimi i Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar

Rreshtimi i Shqipërisë në anën e drejtë të historisë



Halil Rama

VAZHDIM I KUVENDEVE HISTORIKE TË POPULLIT SHQIPTAR PËR BASHKIM

- *Lufta Nacional-Çlirimtare, e orientuar, e udhëhequr dhe e frymëzuar nga idealet e mëdha të Konferencës së Pezës bëri të mundur që Shqipëria të jetë kontributore e çmuar në koalicionin e madh antifashist botëror, në koalicionin e vlerave*

Në fshatin Pezë, rreth 20 kilometra larg Tiranës, 76 vjet më parë më 16 shtator 1942, u mbajt Konferenca e Pezës, e njohur në historinë e popullit shqiptar si kuvendi i parë pluralist. Protagonistë të këtij kuvendi, ishin përfaqësues të krahinave, besimeve të ndryshme fetare, klasave dhe shtresave me bindje politike nga më të ndryshmet. Kur u mor vendimi për thirrjen e Konferencës, vendi ndodhej i pushtuar nga Italia dhe i rrezikuar me asgjësim total të vlerave më të qenësishme kombëtare, kurse shoqëria shqiptare e mbërthyer në probleme dhe kontradikta të mprehta politike, ideologjike dhe sociale. Në Pezë, kuvenduan nacionalistë, demokratë, komunistë dhe zogistë, duke iu dhënë rrugëzgjidhje çështjeve të bashkimit të popullit si çështje kardinale për të ruajtur indentitetin kombëtar. Në këtë konferencë morën pjesë personalitete të rrymave të ndryshme politike, që nga Abaz Kupi, Mustafa Gjinishi dhe Myslym Peza, që përfaqësonin shtresat patriotike të asaj kohe. Konferenca e Pezës u karakterizua nga debate të gjalla, disa herë të ashpra për probleme të rëndësishme të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, të strategjisë dhe të taktikës së saj. Mendimet e patriotëve vinin në këtë mbledhje nga pozicionet, mentalitetet dhe interesat e ndryshme të delegatëve, respektivisht të forcave politike që ato përfaqësonin. “Pikëpamjet politiko-shoqërore të rrymave të ndryshme nuk duhet të bëhen pengesa për luftën e popullit shqiptar”, u theksua ndër të tjera në këtë konferencë. Vendimet e kësaj konference, që zgjodhi Këshillin e Përgjithshëm, me kryetar Kamber Qafmolla, sekretar Mustafa Gjinishi dhe 7 anëtarë, patën jehonë dhe ndikuan në organizimin e popullit shqiptar në ngjarjet e Luftës së Dytë Botërore.

Konferenca e parë pluraliste Nacionalçlirimtare e Pezës është vazhdim i Kuvendeve historike të popullit shqiptar për bashkim, sepse bashkimi është i vetmi kusht për të korrur fitore. Në Konferencë fitoi ideja që Shqipëria të ishte “Shqipëri e lirë, e pandashme, indipendente dhe demokratike” (Rez. fq.10). Si përfundim, Konferenca e parë pluraliste Nacionalçlirimtare e Pezës gjeti si zgjidhje më të përshtatshme për t’iu përmbajtur parimit të vetëvendosjes në fund të Luftës, ashtu siç e përmbante Karta e Atlantikut, për të cilën ishin zotuar aleatët e mëdhenj të koalicionit antifashist: SHBA, Rusia dhe Britania e Madhe.

Pa dyshim vendimi më i rëndësishëm që mori Konferenca ishte krijimi i Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar, si një organizatë mbipartiake, ku do të bënin pjesë të gjithë shqiptarët pa dallim feje apo bindje politike. Përsa i përket çështjes së Kosovës, delegatët vendosën që ajo të zgjidhej në bazë të principit të vetëvendosjes si e parashikonte Karta e Atlantikut. Tani, mbas 76 vjetësh, mbetet i njëjti vlerësim për qëllimet dhe rolin historik të Konferencës së Pezës, çka do të thotë që ajo i qëndroi historisë. Ajo ishte dhe mbeti një ngjarje e rëndësishme e historisë, pikërisht për mesazhet që i dha vendit, në qendër të të cilave ishin liria dhe demokracia, bashkimi dhe qëndresa, fitorja dhe prosperiteti.

Pavarësisht dritëhijeve që shoqërojnë ngjarjet e mëdha historike, populli i Pezës duhet të ndjehet krenar që është në qendër të një prej ngjarjeve më të rëndësishme të Luftës dhe Rezistencës Antifashiste për çlirim kombëtar.

SHQIPËRIA, KONTRIBUTORE E ÇMUAR NË KOALICIONIN E MADH ANTIFASHIST BOTËROR

Populli i Pezës duhet të ndjehet krenar që është në qendër të një prej ngjarjeve më të rëndësishme të Luftës dhe Rezistencës Antifashiste për çlirim. Ajo kishte një traditë të shkëlqyer rezistence ndaj pushtuesit italian që nga prilli i 1939-ës dhe deri në kohën

KALENDARI

Ngjarje të rëndësishme historike gjatë Luftës së Dytë Botërore në shtatorët e viteve 1942-1945

- 2 shtator 1945** - Kapitulloi Japonia Fashiste. 9 Shtator 1943 - Thirrje popullit shqiptar për kapitullimin e Italisë Fashiste.
- 4 shtator 1943** - Në Konferencën e Partisë Komuniste në Labinot, 4-8 shtator 1943, u dënua zyrtarisht Marrëveshja e Mukjes dhe u vendos t'i shpallej luftë e armatosur Ballit Kombëtar, me të cilin pak kohë më kishin qenë partnerë, si edhe çdo rryme apo tendence tjetër politike. Për këtë arsye, Konferenca e Labinotit u quajt “momenti vendimtar drejt marrjes së pushtetit” dhe i nisjes së luftës civile në Shqipëri. Nga ky moment, lufta e armatosur ndaj kundërshtarëve politikë do të ishte prioriteti i politikës së PKSH dhe E.Hoxhës. Vendimi i marrë në Konferencën e Labinotit që pushteti i Këshillit NÇ të ishte pushteti i vetëm, haptë rrugën e një sistemi njëpartiak dhe të një pushteti totalitar në Shqipëri. Thelbi i të cilit qëndronte në sundimin e një partie të vetme, Partisë Komuniste.
- 9 shtator 1944** - U formua Brigada XX Sulmuese e UNÇI Shqiptare në fshatin Protopapë të Korçës.
- 9 shtator 1944** - U çlirua Bullgaria nga Ushtria Sovjetike – Përmbysja e diktaturës fashiste në Bullgari.
- 10 shtator 1944** - Lufta për çlirimin e Gjakovës prej gjermanëve (10-16 shtator) nga forcat çlirimtare të Kryezinjve (Gani, Hasan dhe Sait Kryeziu), ku bënte pjesë edhe Llazar Fundo, komisar politik i Lëvizjes Kryeziu, si edhe oficeri britanik Simkoks. Kur luftonin kundër pushtuesve gjermanë, forcat e Kryezinjve u goditën nga forcat partizane të Brigadës V të Shqipërisë dhe forcat NÇ të Jugosllavisë (Kosmetit), të udhëhequra nga Fadil Hoxha.
- 12 shtator 1944** - Dita e çlirimit të qytetit të Beratit.
- 13 shtator 1942** - U formua Çeta e Lumës
- 14 shtator 1943** - Filloi Lufta e Drashovicës (Vlorë) kundër garnizont armik, nga batalionet partizane “Halim Xhelo” e “Ismail Qemali, si dhe nga 4 batalione të krijuara nga vullnetarët dhe nga i gjithë populli i fshatrave të afërta.
- 15 shtator 1942** - Dita e çlirimit të Çorovodës.
- 16 shtator 1942** - Konferenca e Pezës, hapi parë për krijimin në formë organizative të Frontit NÇI, ku morën pjesë PKSH dhe përfaqësuesit e tendencave të ndryshme të nacionalistëve shqiptarë. Konferenca e Pezës në programin e saj politik kishte: luftën e organizuar të ashpër e pa kompromis kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve, me parullën: bashkim pa dallim feje, krahine dhe ideje.
- 16 shtator 1944** - U formua Brigada XIX Sulmuese e UNÇI Shqiptare.
- 18 shtator 1944** - U formua Brigada XXII Sulmuese e UNÇI Shqiptare, në Pezë të Tiranës.
- 18 shtator 1944** - Dita e çlirimit të qytetit të Gjirokastrës.
- 20 shtator 1943** - U formua në qytetin e çliruar të Beratit batalioni “Margarita Tutulani”. 21 shtator 1944 - U formua Brigada XXIII sulmuese e UNÇI Shqiptare, në Zall-Mner të Tiranës.
- 22 shtator 1942** - dha jetën Heroi i Popullit Nazmi Rushiti.
- 22 shtator 1943** - Forcat partizane të qarkut të Tiranës zhvillojnë luftime të ashpra me gjermanët për mbrojtjen e Krutës.
- 22 shtator 1944** - Dita e çlirimit të qytetit të Krutës.
- 23 shtator 1944** - Llazar Fundo, figurë e shquar e socialdemokracisë europiane, i cili, bashkë me Kryezinjët, po luftonte kundër gjermanëve për çlirimin e Gjakovës, u arrestua nga forcat e Brigadës V të Ushtrisë NÇ të komanduar nga Shefqet Peçi dhe u pushkatua në Kolesian pa gjyq, me urdhër të E.Hoxhës me radiogram: “Zai Fundon ta torturonin deri në vdekje dhe pastaj ta vrisni andej”.
- 25 shtator 1944** - Masakra e Brigadës V. Me urdhër të komandantit të saj, Shefqet Peçi, u pushkatuan pa gjyq në Krue të Bardhë të Lumës 22 lumjanë të pafajshëm, të lidhur me konop me njëri-tjetrin, si hakmarrje për vrasjen e nipit të tij, Hysen Çino.
- 26 shtator 1944** - U formua Brigada XVII Sulmuese e UNÇI Shqiptare, në Gjinë të Elbasanit

kur do të mbahej Konferenca. E ndodhur ndërmjet qyteteve më të rëndësishme të vendit dhe e rrethuar nga kurora e maleve, i jepte rëndësi të veçantë strategjike në organizimin e rezistencës kombëtare. Kjo ishte arsyeja përse Peza u zgjodh si vendi që do të mirëpriste Konferencën që do të shënonte një pikë kthese për rezistencën tonë kundër nazi-fashizmit.

Pavarësisht dritëhijeve që sho-

qërojnë ngjarjet e mëdha historike, Konferenca e Pezës ishte përpjekja e parë madhore e popullit shqiptar për t’u bashkuar në luftën për çlirimin e vendit nga pushtuesit. Ajo u diktua nga zhvillime të rëndësishme ndërkombëtare, por edhe nga nevoja e brendshme e vendit për unitet kundër pushtuesit.

(Vijon në faqen 4)

HISTORIA

74- vjetori i krijimit

Brigada XXIII Sulmuese Partizane në betejat për liri

Krijimi i Brigadës së 23-të Sulmuese, 74 vjet më parë, në Zall Mner, ishte e domosdoshme, pasi LANÇ kishte marrë përmasa të mëdha në të gjithë vendin dhe kështu ishin krijuar kushtet e rrethanat për krijimin e një brigade dhe në rrethin e Krujës. Kështu më, më 21 shtator 1944, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të UNCSH, në Zall-Mener, u krijua Brigada e 23 Sulmuese Partizane.

Kjo brigadë u formua nga batalionet partizane "Dajti", "Kruje-Ishem" dhe "Mat" te cilët kishin në efektivin e tyre partizanë me pervojë, të kalitur në aksione luftarake kundra nazifashizmit italo - gjerman si dhe tradhtarëve të vendit, që kishin kaluar prova të rënda sakrificash në luftë, sidomos gjatë Operacionit të Dimrit 1943 dhe të Qershorit 1944. Drejtuesit e shtabit të Brigadës u caktuan: Hamit Keçi, Haxhi Seseri, Muharrem Kokomani; Xhavit Qesja, Mërkur Çela Haki Fejzo, Sejdin Avdia etj.

Sapo u formua brigada me drejtuesit e saj, u ngarkua me detyren luftarake që të merrnin pjesë në luftën për Çlirimin e Tiranës, Krujës, Vorës, Fushë-Krujës, Prezës, Milotit, Pukës, Mirditës, Matit, Lezhës e deri në Shkodër.

Brigadës i ngakohej detyra që të godiste perqendrimet armike të vendosura në ato zona dhe të shkateronte forcat mercenare, si ato zogjstos - balliste, të cilët bashkëpunonin me pushtuesit nazifashistë të perqendruara në kalatë e Krujes, Prezës e Ishmit. Gjithashtu Brigada do të godiste forcat nazistye që do të lëviznin nga Tirana për në Veri, në zonat ku ishte përqëndruar armiku.

Luftrat e aksionet e Brigadës së 23-te sulmuese ishin shumë të suksesshme. Brigada e përbërë nga djem të e popullit gjeti përkrahje të fuqishme nga populli dhe kudo që shkoi u ndihmua pa rezervë... Mbështetje të fortë pati edhe nga Këshillat ANÇ, si dhe familjet që i kishin kthyer shtëpitë bazë lufte.

Kjo Brigadë në bashkëpunim me Brigadën I Sulmuese bënë një luftë tepërt të organizuar kundër nazistëve gjermanë e bashkëpunëtorëve të tyre në Krujë dhe si rezultat, më 22 1944 shtator, u çlirua Kruja. Luftërat u bënë nga një zone në tjetren dhe arriten deri në Shkodër. Në mengjesin e

• *Kjo brigadë u formua nga batalionet partizane "Dajti", "Kruje-Ishem" dhe "Mat" te cilët kishin në efektivin e tyre partizan me pervojë, të kalitur në aksione luftarake kundra nazifashizmit italo - gjerman si dhe tradhtarëve të vendit, që kishin kaluar prova të rënda sakrificash në luftë, sidomos gjatë Operacionit të Dimrit 1943 dhe të Qershorit 1944. Drejtuesit e shtabit të Brigadës u caktuan: Hamit Keçi, Haxhi Seseri, Muharrem Kokomani; Xhavit Qesja, Mërkur Çela Haki Fejzo, Sejdin Avdia, etj.*



29 nentorit 1944 forcat e kesaj brigade pas një lufte të ashpër për çlirimin e Shkodres, duke iu bashkuar forcave të brigadave 6-te, 7, 22 dhe 24-t dhe grupeve partizane të Shkodres, e të gjithë bashkë shporrën pushtuesit dhe bashkëpunëtorët e tyre nga qytetit dhe e çliruan atë edhe me ndihmën e popullit.

Çlirimi i Shkodres shenoi dhe çlirimin e gjithë Shqipërisë nga pushtuesit nazifashistë. Kjo qe nje ngjarje me rëndesi të madhe historike dhe u përhap në të gjithë vendin.

Ndër luftrat që ka zhvilluar kjo Brigadë kanë rënë 23 dëshmorë. Në formacionet partizane kanë qenë edhe heronjtë e popullit Mustafa Kaçaçi, Bab Rexh Deliu. Por dhe heroina kosovare Shote Galica.

Në Krujë, te kthesa e rrugës që shkon për në Qafshatë, për te per-

jetesuar formimin e Brigades 23 S , luftën e saj heroike kundër armiqe si dhe dëshmorët e saj, është ngritur lapidari ku janë skalitur emrat e të gjithë dëshmoreve të saj si me poshte:

1. Abaz Veseli
2. Adem Gjeli
3. Ali Metra
4. Avdi Kazani
5. Riza Beak
6. Bakushe Visha
7. Besim Beja
8. Gani Guxhiqi
9. Islam Shehi
10. Luigj Kurti
11. Njazi Meka
12. Llesh Spaçi
13. Mustafa Dervishi
14. Mustafa Mezini
15. Ibrahim Liçi
16. Ramazan Zambaku

17. Rexhep Shira
18. Shaban Lika
19. Turabi Dura
20. Vath Bushi
21. Vesel Brama

Populli i Krujës duke perkujtuar rrugen e lavdishme luftarake te Brigades 23-te sulmuese, i shpreh mirenjohje te gjithë partizanëve qe benin pjesë në këtë brigade dhe te gjithë familjeve të tyre, shtepive baze te LANÇ dhe përulet me respekt te thelle perpara dëshmoreve te kesaj brigade dhe familjeve te tyre.

SEFER BOJA
Veteran i LANÇ

(Marre nga faqja "Veteranët e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare Shqiptare" në facebook)

Rreshtimi i Shqipërisë në anën e drejtë të historisë

(Vijon nga faqja 3)

Pavarësisht efekteve dhe ndikimeve që pati kjo Konferencë, një moment është shumë i rëndësishëm për t'u theksuar. Ishte pika e nisjes së rreshtimit të Shqipërisë në anën e drejtë të historisë. Shqipëria u vendos në krah të aleatëve kundër barbarisë nazi-fashiste, duke dhënë kontributin e saj, e që sot na bën të ndjehemi krenar për këtë qëndrim.

Peza duhet të finalizohet në Mukje për të çuar vërtetë vendin në drejtimin e duhur, por ky ishte shansi

ynë i humbur për të fituar pas luftës edhe paqen. Për fat të keq, ata që fituan luftën, humbën paqen. Fundi i pushtimit, ngadhënjimi i lirisë kombëtare u bë pragu i humbjes së lirisë politike. Sot ne kujtojmë me nderim më shumë se gjithçka tjetër, atë përpjekje për unifikimin e faktorit shqiptar në Luftën e Dytë Botërore, një ndarje mes demokracive dhe totalitarizmit, kur u vu në pikëpyetje vetë qytetarimi europian.

Lufta Nacional-Çlirimtare, e orientuar, e udhëhequr dhe e frymëzuar nga ideat e mëdha të Konferencës

së Pezës bëri të mundur që Shqipëria të jetë kontributore e çmuar në koalicionin e madh antifashist botëror, në koalicionin e vlerave.

Sot populli shqiptar po ecën i sigurtë drejt integritetit në Bashkimin Europian dhe në Aleancën e Atlantikut të Veriut, drejt Europës së qytetëruar dhe demokratike, ashtu siç bëri në vitet e vështira e të lavdishme të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare duke u radhitur përkrah koalicionit të madh antifashist botëror.

Megjithëse kanë kaluar 76 vjet që kur u mbajt Konferenca e parë plu-

raliste Nacionalçlirimtare e Pezës, ajo edhe sot e ruan aktualitetin e saj. Ne shqiptarët si komb e si popull duhet të konsolidohemi dhe të bëjmë realitet ëndërrën tonë të pashuar europiane.

Premtimi për çeljen e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian qershorin e vitit 2019 është garanci për një ecje të mbarë të proceseve integruese, por njëherësh dhe detyrim madhor i secilit për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshjet me BE-në.

DEKLARATA

Organizata e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare të Kosovës hedh poshtë deklaratën e ish - kryeministrit dhe ish - Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha

Fadil Hoxha, ideator i ndërtimit të identitetit kushtetues të Kosovës

• Kryetari i Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të LANÇ të popullit shqiptar, gjeneral-lejtënant Rrahman Parllaku - Heroi i Popullit dhe Nderi i Kombit, me rastin e shënimit të 100 vjetorit të lindjes së Fadil Hoxhës, tha se ai ishte luftëtar, patriot dhe burri i shquar i kombit tonë

Organizata e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare të Kosovës, (OVLANÇ) dhe dega e saj në Gjakovë, analizuan intervistën e ish - kryeministrit dhe ish - Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha, dhënë gazetarit Ermal Panduri, në një edicion special që u transmetua në RTV Dugagjini, me ç'rast u përmend edhe komandanti i aradhave partizane të Kosovës, Hero i Popullit Fadil Hoxha.

Sali Berisha, me injorimin e fakteve historike u përpoq të përçojë mesazhe që fajësojnë personalitetin dhe veprën e Heroit të Popullit Fadil Hoxha duke thënë se "ka anuluar vendimet e Konferencës së Bujanit, sebashkë me Enver Hoxhën kanë tradhtuar në mënyrë më të pabesë këto vendime dhe se nuk mund t'i ngrihet një përmendore për te".

OVLANÇ hedh poshtë këto deklaratat të Sali Berishës dhe vlerëson se Fadil Hoxha ka qenë një figurë e veçantë politike, ideologjisht dhe intelektualisht i formuar në Shqipëri.

Fadil Hoxha ka patur një karrierë të gjatë politike dhe ka ushtruar ndikim të madh në jetën politike dhe shoqërore të shqiptarëve. Në sajë të lavdisë së fituar në Luftën Antifashiste dhe angazhimit të tij për zgjidhjen e çështjes kombëtare e sociale të shqiptarëve, deri në fund të jetës ishte i çmuar dhe i dashur në popull. Ideali i tij ishte bashkimi i Kosovës me Shqipërinë. Dëshmia më e mirë për këtë është Konferenca e Bujanit që u organizua dhe u mbajt me nismën e tij. Konferenca e Bujanit u mbajt më 31 dhjetor 1943 - 2 janar 1944, ku tri ditë radhazi u shqyrtuan problemet që dilnin nga lufta kundër pushtuesit. Konferenca doli me një dokument përfundimtar, ku thuhet: "Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit



është krahinë e banuar me shumicë nga populli shqiptar, i cili, si gjithmonë, ashtu edhe sot, dëshiron me u bashkue me Shqipërinë". Mirëpo, në Prizren me 8-10 korrik 1944, në Konferencën e Këshilit Nacional Çlirimtar të Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjini u hodhën poshtë vendimet që ishin marrë në Bujan. Pjesëmarrësit shqiptarë në këtë Konferencë u detyruan me dhunë të miratojnë vendimin "që Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit t'i bashkohen Serbisë Federale". Në pamundësi të sendërtojë idealet që e çuan në luftë, Fadil Hoxha formuloi një synim tjetër që ishte zhdukja e analfabetizmit, shkollimi i rinisë, emancipimi i përgjithshëm i popullit dhe ndërtimi i identitetit kushtetues të Kosovës. Menjëherë pas rënies së Aleksandër Rankoviçit, polikanit serb antishqiptar, Fadil Hoxha kishte kërkuar më shumë bashkëpunim me

Shqipërinë dhe emrit të Kosovës t'i hiqet Metohija, gjë që ka ndodhur. Po ashtu kërkoi që Kosova të sjell ligjet e saj, përfshirë Gjykatën Supreme, të ketë flamurin zyrtar, stemën dhe festën e vetë shtetërore.

Kryetari i Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të LANÇ të popullit shqiptar, gjeneral-lejtënant Rrahman Parllaku - Heroi i Popullit dhe Nderi i Kombit, me rastin e shënimit të 100 vjetorit të lindjes së Fadil Hoxhës, tha se ai ishte luftëtar, patriot dhe burri i shquar i kombit tonë dhe shtoi: "Fadili me shokët, nuk mund ta ndanin Kosovën nga ish-Federata Jugosllave, kur ajo kishte mbetur pjesë e saj pas luftës. Po ata, me përpjekje të vazhdueshme, duke luftuar pa pushim shovinizmin serb arritën t'i bënë Kosovën e shqiptarët të barabartë me kombet tjera të Federatës".

Fadil Hoxhës kishte rolin prijës në emancipimin e përgjithshëm politik e arsimor, kulturor dhe kombëtar të shqiptarëve. Edhe pse me bashkëveprimtarët u ballafaquan me shumë sfida, dhe pa marrë parasysh kushtet që jo vetëm nuk ishin të lehta por ishin edhe me rreziqe, arritën të sigurojnë shkollimin e disa qindra mija nxënësve, disa dhjetëra mijra student të studjojnë në fakultetet e Universitetit të Prishtinës, disa mijra të magjistrojnë e doktorojnë. Themeluan institucionet shkencore, Institutin Albanologjik, Institutin e Historisë, Akademinë e Shkencave dhe Arteve. Krijuan kushte për emetimin e programit të Televizionit të Prishtinës. Në vepërimtarinë botuese,

përveç botimeve të librave në gjuhën shqipe, filluan të botohen edhe përkthime të autorëve të huaj. Krijimtaria artistike morri hov. Veprat nga lëmia e letërsisë, pikturës, muzikës, kinematografisë, filluan të tejkojnë nivelin lokal.

U krijuan kushte të volitshme për bashkëpunim me Shqipërinë në fushën e arsimit dhe kulturës... Mirëpo, me këto arritje nuk pajtohej dhe ishte shqetësuar klasa politike intelektuale dhe nacionalistët serbe. Në mediat e tyre, Fadil Hoxhën e akuzonin si fajtor për përhapjen e nacionalizmit shqiptar. Para shtëpisë së tij u organizuan demonstrata masive të serbëve të cilët me kërcënime, thyerje, bashkë me parullën "Duam armë" kërkonin që Fadil Hoxha të vihet mbi hu dhe të vritet.

Udhëheqja partiake jugosllave e ngriti komisionin e veçantë për përgjegjësinë të tij. Spekulonin se shqiptarët gjatë okupacionit kanë qenë në anën e fashizmit dhe kërkonin që shqiptarëve t'u hiqen të drejtat që kishin fituar në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore e posaçërisht ato të drejta që ishin të garantuara me Kushtetutën e vitit 1974".

Në intervistën dhënë RTV Dugagjini, ngjashëm me shovinistët e ultranacionalistët serbë dhe "ideologët e Serbisë së madhe" veprimi edhe Sali Berisha. Vlerësimi i tij se Fadil Hoxha është tradhtar, është ofendim dhe mohim i meritave të rreth 50 mijë luftëtarëve kosovarë (në kohën kur Kosova kishte vetëm afro 400 mijë banorë) të cilët krah për krah me luftëtarët antifashistë të Shqipërisë dhe të botës përparimtare dhanë një kontribut të theksuar në çlirimin jo vetëm të Kosovës.

OVLANÇ vlerëson se krahasimi dhe barazimi që bëri Sali Berisha mes Enver Hoxhës dhe Fadil Hoxhës është absolutisht pa vend. Fadil Hoxha nuk la pas veti tortura dhe krime ndaj popullit të vetë, as vëllime të mëdha të shkruara për socializmin, marksizëm-leninizmin e as për stalinizmin si që i la Enver Hoxha. Ndërkaq, ngritja e shtatores, Fadil Hoxhën nuk e bënë as më të madh e as më të vogël. Por do jetë një hallkë në zinxhirin patriotik dhe luftarak të Gjakovës brez pas brezi, që nga Sulejman Vokshi, Bajram Curri, Emin Duraku e gjer te herojtë e fundit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së) të cilët ai i përkrahu deri në fund.

OVLANÇ të Kosovës dhe dega në Gjakovë
Prishtinë, 23 gusht 2018



FORUM

DEKLARATA DELUZIONISTE PËR KUFIJTË QË USHQEJNË KAOSIN DHE FRIKËN

Sovraniteti dhe integriteti i Republikës

Nga Bashkim HISARI

Serbia nuk po zbaton marrëveshjet e nënshkruara në Bruksel si: Marrëveshjen për energjinë, për menaxhimin e integruar të kufijve, hapjen e Urës së Mitrovicës, njohjen e diplomave, lirinë e lëvizjes. Nuk po paguajnë borxhin për pensionistët e Kosovës, më shumë se 860 milion euro. Po ndalojnë pa arsye qytetarët e Kosovës në kufi, nuk po ua lejojnë hyrjen në Serbi, po zbatojnë procedura gjyqësore dhe po shqiptojnë dënime marramendëse. Ish-kryetarit të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, njëherësh anëtar i Akademisë Evropiane të Shkencave dhe Arteve, Hivzi Islamit, dy herë i është ndaluar hyrja në Serbi. Kohë më parë hyrja në shtetin serb i ndalua edhe publicistit kosovar Shkëlzen Maliqi. Po u nxjerrin telashe qytetarëve që posedojnë patentë të shoferit Kosovar duke mos iu pranuar ato andej kufirit, sikurse edhe targa e makinave me regjistrimin e Kosovës, bile edhe në Veri të Kosovës. Atëherë, si mund të presim që Serbia të lejojë bashkimin e Luginës së Preshevës me Kosovën? Me manipulime dhe spekulime të spektrit politik në Serbi dhe të një pjese të atyre në Kosovë nuk mund të arrihet ndonjë marrëveshje për zgjidhje e problemeve

Ndërkaq, edhe Presidenti i Serbisë, Vuçiq u angazhua hapur për ndarjen ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë. Ai deklaroi se është në favor për ndarje me shqiptarët sepse siç tha: "kemi një territor që nuk dihet se kush e trajton atë dhe çfarë i përket, është gjithmonë një burim konfliktesh të mundshme". Vuçiq shtoi se nuk dihet nëse këtë do ta pranojë populli serb apo jo dhe, nëse do të ketë sukses, pasi sipas tij kjo nuk varet vetëm nga Serbia.

Për Vuçiqin dhe politikanët tjerë në Serbi, korrigjimi i kufijve nuk nënkupton ndarjen e Luginës së Preshevës nga Serbia, por bashkimin e Veriut të Kosovës me Serbinë. Presidenti Vuçiq bashkë me Ministrin e Jashtëm të Serbisë, Ivica Daciq ishin dy njerëzit kryesorë të Slobodan Millosheviçit gjatë kohës së luftës në Kosovë, në vitet 1998-1999.

Këto ide dhe kërkesa, po ballofaqohen me kundërshtime të mëdha nga shumica e palëve.

THAÇI, KA MBETUR I VETËM NË INICIATIVËN PËR KORRIGJIM TË KUFIJVE

Faktori politik në Kosovë po e kundërshton preken e kufijve. Thaçi, ka mbetur i vetëm në iniciativën për korrigjim të kufijve. Ai nuk e ka mbështetjen e partive politike, as në pushtet e as në opozitë. Thaçit i duhet mbështetja e partive politike pasi çdo marrëveshje eventuale ndërmjet tij dhe presidentit serb, do të duhet të votohej në Parlament.

Për kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj, prekja u kufijve nënkupton luftë. Ai thekson se është rrezik me folë për ndarje dhe se për të "ndarja e kufijve është luftë".

Kryeparlamentari, njëherit kryetar i PDK-së, Kadri Veseli, tha se sovraniteti dhe integriteti i shtetit janë të pacënueshme. "Çdo deklaratë tjetër, çdo qëllim tjetër, më tepër është lojë për me nxitë pasiguri, frikë dhe paqartësi, që më së paku i bën dobi Kosovës dhe qytetarëve të saj" theksoi Veseli.

Ndërsa, kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, është i mendimit se problemi i Luginës, nuk rregullohet me logjikën e korrigjimit të kufijve. Shkëmbimi i territoreve ose korrigjimi

• *Shqiptarët dhe serbët kanë nevojë për paqe të qëndrueshme dhe siguri e jo të luftojnë e të vriten për territore. Kanë nevojë për më shumë rezultate të prekshme politike e më pak fjalë. Jo të rivizatojnë kufijtë, por të ndryshojnë politikën e tyre. Zgjidhja e problemit mund të jetë krijimi e një politike alternative të bazuar në një ekuilibër pragmatik të pakënaqësive, që objektivisht ekzistojnë në radhët e shqiptarëve dhe serbëve, me domosdoshmërinë e komunikimit mes tyre dhe mbështetjen e faktorit ndërkombëtar që do të garantojë një tranzicion më të suksesshëm dhe krijon kushte më të volitshme për antarsim të dy shteteve në BE dhe NATO*

i kufijve mes Prishtinës dhe Beogradit mund të ketë pasoja të dëmshme dhe sipas tij bisedat për territore më shumë çojnë në luftë se në paqe.


Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa është shprehur se deklaratat për korrigjim kufijsh janë retorikë shterpe dhe të rrezikshme.

Përfaqësuesit e disa shteteve më të zhvilluara, poashtu janë kundër lëvizjes së kufijve. Shumica theksojnë se normalizimi i marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë është vendimtar për sigurinë, stabilitetin dhe prosperitetin e të dyja vendeve dhe rajonit në tërësi dhe për këtë arsye vazhdojmë ta mbështesim dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian (BE) për gjetjen e një zgjidhjeje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme me të cilën përfitojnë të dy vendet.

Brukseli duket i gatshëm të pranojë një marrëveshje për të cilën palët do të pajtohen, ndërsa më herët vazhdimisht ka kritikuar fort teza të tilla!!! Për BE-në zgjidhje e përhershme nënkupton një zgjidhje realiste, të qëndrueshme dhe të mundshme, në pajtueshmëri me të drejtën ndërkombëtare mbi të cilën Prishtina dhe Beogradi duhet të kenë pajtueshmëri.

SHBA-JA NUK E PËRKRAHIN IDENË PËR SHKËMBIM TERRITORESH MES KOSOVËS DHE SERBISË

Rreth 30 Organizata Joqeveritare nga Kosova dhe Serbia janë bërë bashkë dhe i kanë bërë thirrje përfaqë-



sueses së lartë të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, që të dalë me një deklaratë të qartë kundër ndarjes së Kosovës apo shkëmbimit të territoreve mes Kosovës dhe Serbisë në parimin etnik.

Në momentin kur në fokus të mediave ishte demarkacioni, korrigjimi i kufijve dhe format e ndryshme të ndarjes, një nga mesazhet më të rëndësishme erdhi nga shteti më i fuqishëm i BE-së, Gjermania. Kancelarja Angela Merkel u shpreh kundër ideve për ndryshimin e kufijve të jashtëm në Ballkanin Perëndimor. Ajo tha se "integriteti territorial i vendeve të Ballkanit Perëndimor është i përcaktuar dhe i paprekshëm".

Ambasada Amerikane në Prishtinë, bëri të ditur se Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nuk e përkrahin idenë për shkëmbim territoresh mes Kosovës dhe Serbisë.

Rusia, e cila është lojtar i rëndësishëm për shkak të fuqisë së vetos dhe pozitës globale që ka, dhe që është tradicionalisht në anën e Serbisë, po angazhohet në favor të qëndrueshmërisë dhe sovranitetit të territorit serb. "Do të respektojmë të gjitha vendimet e marra nga Serbia në raport me Kosovën" -deklaroi zëdhënësjja e Ministrisë së Jashtme ruse, Maria Zaharova.

Ndërkaq ultranacionalisti serb Vojislav Sheshel i cili është dënuar me 10 vjet burg nga Tribunali i Hagës për krime lufte, tani deputet në Kuvendin e Serbisë, duke prezantuar "propozimin" e tij për zgjidhjen e çështjes së Kosovës, bënë thirrje për luftë me shqiptarët dhe synon që Serbia të marrë edhe pjesën veriore të Shqipërisë. Përmes një postimi në Twitter ka treguar se Serbia duhet të përgatitet që me luftë sërish ta marrë Kosovën. "Që të çlirojmë Kosovën e Metohinë, ne duhet me forcat tona të fuqishme ushtarake polico-re të dëbojmë të gjithë shqiptarët


që nuk e njohin shtetin serb", ka deklarua ai. Kryeçetniku serb, ish-shefi "i propagandistëve të Serbisë së Madhe" propozimin e tij e zgjeroi dhe përfshiu edhe Veriun e Shqipërisë duke thënë: "Nuk duam kurrëfarë demarkacioni me shqiptarët. Ne serbët duhet të bëjmë demarkacionin në Shqipëri me grekët, diku në rripin e Durrësit. Perandoria Austro-Hungareze e krijoi Shqipërinë si një shtet artificial, për të parandaluar Serbinë të dalë në det. Në Shqipërinë e Veriut, është trashëgimia jonë. Atje gjithçka është serbe, edhe toka dhe guri", ka shkruar Sheshel.

KUFIJTË E SOTËM TË KOSOVËS U CAKTUAN PAS LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

Kufijtë e sotëm të Kosovës u caktuan pas Luftës së Dytë Botërore kur edhe u caktuan kufijtë e brendshëm të Jugosllavisë. Këto kufij nuk ishin historikë e as etnikë, por produkt i një marrëveshjeje të organizimit partiak të ish Jugosllavisë. Me atë rast u krijuan "Krahinat partiake" të Sanxhakut, Maqedonisë, Kosovë-Metohisë, Dalmacisë, Kroacisë... Në mbledhjen e dytë të AVNOJ-it në Jajcë (1943) ku formalisht u kodua kjo ide, u vunë themelet e Jugosllavisë. Në këtë mbledhje Kosovën nuk e përfaqësonte asnjë shqiptar. Kështu kufijtë e Krahinës së re të Kosovë-Metohisë (si e quajten atëherë), u bënë ashtu siç e deshën jo-shqiptarët. Brenda Serbisë u krijuan dy Krahina. Me këto kufij të imponuar nuk ishin të kënaqur shqiptarët e Kosovës, të cilët nuk patën alternativë e as mundësi për të bërë ndryshime. Në kundërshtim me ligjshmëritë historike pas fitores së forcave partizane ndaj okupimit fashist, bashkimi i Kosovës me Shqipërinë nuk u realizua. Për t'i kundërshtuar vendimet e Mbledhjes së AVNOJ-it dhe mos përfshirjen e Kosovës si subjekt i pavarur, në fshatin Bujan u mbajt

REPORTAZH

së Kosovës janë të pacënueshëm



kruesit e Marrëveshjes Ushtarako-Teknike të Kumanovës, me të cilin iu dha fund luftës në Kosovë, pastaj kufi edhe për Misionin e përkohshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, i cili do të administronte Kosovën për një periudhë të caktuar kohore dhe për Planin e Ahtisarit-Propozimit Gjithëpërfshirës për Vendosjen e Statusit të Kosovës.

Thirrjet aktuale për modifikim të kufijve dhe lëvizjen e territoreve nacionale mund të jenë destabilizuese dhe provokim për rihapjen e konflikteve të reja mes Kosovës dhe Serbisë që do të kishte efekte negative zinxhimore në tërë gadishullin Ballkanik. Njëherit do të ishte në kundërshtim me Aktin e Pavarësisë, Kushtetutën e Kosovës, Vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë se Kosova kishte të drejtë ta shpallë pavarësinë dhe me 116 njohje të Kosovës me kufijtë aktuale. Shkëmbimi eventual i territorive, Veriut të Kosovës me Luginën e Preshevës për njohjen e Kosovës, faktikisht do ishte ndarje etnike që do të dërgonte pashmangshëm në zhvendosjen e popullatës. Katër komuna në Veri të Kosovës, Mitrovica Veriore, Zveçani, Leposaviqi dhe Zubin Potoku janë të banuara me shumicë serbe. Sipas të dhënave të OSBE, këto katër komuna janë të banuara me 70.430 serbë, 6.970 shqiptarë dhe me një numër të komunitetit boshnjakë, romë, ashkali dhe egjiptas. Në anën tjetër Lugina e Preshevës është territor i cili përbëhet nga tri komuna me shumicë shqiptare,

bë nga Lugina e Preshevës.

Presidenti serb, Vuçiç, e ka bërë të qartë se dëshiron të fitojë sa më shumë e të humbë sa më pak, t'i marrë katër komuna me shumicë serbe në Veri të Kosovës, por nuk ka thënë asgjë se ç'ka do të japë si këmbim. Ndaj, në Kosovë pakkush beson se Serbia, që ka ushtruar gjenocid mbi popullin tonë, të bëhet zemërgjerë dhe të pranojë t'i jepet Kosovës edhe Lugina e Preshevës, edhe Veriu i Kosovës dhe se me Serbinë, Kosova do të bëjë shkëmbime paqësore të territorit. Aq më tepër kur Kosova dhe Serbia janë të ngarkuar me në sërë çështjesh të pazgjidhura dhe kur zyrtarët e Serbisë zbatojnë një politikë shoviniste, diskriminuese, dhe nuk po përmbyshin obligimet e marrëveshjeve.

Serbia s'e njeh pavarësinë e Kosovës në kufijtë e saj. Në preambulën e Kushtetutës së Serbisë shkruhet se Kosova është pjesë e saj, pra diçka që nuk ekziston në realitet.

Janë plot 1653 të zhdukur, fati i të cilëve nuk dihet ende, mirëpo, edhe pse Beogradi ka të dhëna mbi vendodhjen e varreve masive, nuk i tregon ato dhe zvarrit procesin për gjetjen e trupave të viktimitave.

Serbia nuk po zbaton marrëveshjet e nënshkruara në Bruksel si: Marrëveshjen për energji, për menaxhimin e integruar të kufijve, hapjen e urës së Mitrovicës, njohjen e diplomave, lirinë e lëvizjes. Nuk po paguajnë borxhin për pensionistët e Kosovës, më shumë se 860 milion euro.

Po ndalojnë pa arsye qytetarët e Kosovës në kufi, nuk po ua lejojnë hyrjen në Serbi, po zbatojnë procedura gjyqësore dhe po shqiptojnë dënime mararamendëse. Ish-kryetarit të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, njëherësh anëtar i Akademisë Evropiane të Shkencave dhe Arteve, Hivzi Islamit, dy herë i është ndaluar hyrja në Serbi. Kohë më pare hyrja në shtetin serb iu ndalua edhe publicistit kosovar Shkëlzen Maliqi. Po u nxjerrin telashe qytetarëve që posedojnë patentë të shoferit Kosovar duke mos iu pranuar ato andej kufirit, sikurse edhe targat e makinave me regjistrimin e Kosovës, bile edhe në Veri të Kosovës.

Atëherë, si mund të presim që Serbia të lejojë bashkimin e Luginës së Preshevës me Kosovën? Me manipulime dhe spekulime të spektrit politik në Serbi dhe të një pjese të atyre në Kosovë nuk mund të arrihet ndonjë marrëveshje për zgjidhje e problemeve.

Negociatat mbi "të ardhmen e Kosovës" janë të pashmangshme, sepse Serbia është një faktor i pakapërcyeshëm për fillimin e njohjes reciproke. Çështja e Kosovës duhet të zgjidhet sa më shpejt. Shqiptarët dhe serbët kanë nevojë për paqe të qëndrueshme dhe siguri e jo të luftojnë e të vriten për territor. Kanë nevojë për më shumë rezultate të prekshme politike e më pak fjalë. Jo të rivizatojnë kufijtë, por të ndryshojnë politikën e tyre. Zgjidhja e problemit mund të jetë krijimi e një politike alternative të bazuar në një ekuilibër pragmatik të pakënaqësive, që objektivisht ekzistojnë në radhët e shqiptarëve dhe serbëve, me domosdoshmërinë e komunikimit mes tyre dhe mbështetjen e faktorit ndërkombëtar që do të garantojë një tranzicion më të suksesshëm dhe krijojë kushte më të volitshme për antarsim të dy shteteve në BE dhe NATO.

• **Serbia nuk e njeh pavarësinë e Kosovës në kufijtë e saj. Në preambulën e Kushtetutës së Serbisë shkruhet se Kosova është pjesë e saj, pra diçka që nuk ekziston në realitet. Janë plot 1653 të zhdukur, fati i të cilëve nuk dihet ende, mirëpo, edhe pse Beogradi ka të dhëna mbi vendodhjen e varreve masive, nuk i tregon ato dhe zvarrit procesin për gjetjen e trupave të viktimitave.**

Konferenca ku u nënshkrua Deklarata, e cila tregonte qartazi ardhmërinë e Kosovës. Me Deklaratën e Bujanit, Kosovës i njihet e drejta e vetëvendosjes deri në shkëputje dhe realizimi i dëshirës së popullit shqiptar të Kosovës për bashkim me Shqipërinë. Në te thuhet: "Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit është krahinë e banuar me shumicë nga populli shqiptar, i cili, si gjithmonë, ashtu edhe sot, dëshiron me u bashkue me Shqipërinë". Por, ky opsion i Komandantit të brigadave partizane, Fadil Hoxha dhe të bashkëluftëtarëve të tij, jo vetëm që nuk u respektua por u degradua, u qortua, u ndalua, faktikisht u bë ripushtimi dhe aneksimi i Kosovës. U ngrit një "mur" i ndarjes ndërmjet Shqipërisë dhe shqiptarëve. Me Rezolutën e Kuvendit të Prizrenit (Mbledhja e dytë e "Këshillit Nacionalçlirimtar" të Kosovës, që u mbajt në Prizren, në muajin korrik të viti 1945, u shpall se "Kosova me dëshirë të popullsisë së saj i bashkoi Serbisë Federale në kuadër të Federatës Jugosllave. Me këtë rast shumë vendime e marrëveshje për vetëvendosje sipas vullnetit të popullit që ishin marrë gjatë LANÇ e në të cilën kishim marrë pjesë rrethë 55 mijë Kosovarë, fare nuk u morën parasysh. Kosova dhe shqiptarët ngelën me kufij të përcaktuar nga të tjerët.

Kufijtë që u përcaktuan zvogëluar territorin e Kosovës. Më vonë, duke

dashur që ta ndryshojnë strukturën etnike dhe dobësojnë dominimin shqiptar të Kosovës, serbët në vitin 1959 u pajtuan që rajoni i qytezës Leposaviqi dhe disa vendbanime me popullatë serbe të Zubin Potokut në Veri të Kosovës të bëhet pjesë e "Krahinës Autonome të Kosovës-Metohisë". Në anën tjetër u bë shkëputja e territoreve të Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës që kanë qenë pjesë e Kosovës. Kjo shkëputje u bë në kuadër të reformave agrare dhe përmes një referendumi të manipuluar popullor. Paralelisht me këtë, është bërë dëbimi i shqiptarëve për në Turqi me qëllim të ndryshimit të strukturës demografike në Kosovë.

ME KUSHTETUTËN E VITIT 1974 KOSOVA ARRITI NË NJË SHKALLË TË LARTË TË PAVARËSISË

Me Kushtetutën e vitit 1974 Kosova arriti në një shkallë të lartë të pavarësisë. Deri në vitin 1989, kur u çrregulluan raportet në Jugosllavi, rrethanat e krijuara bënë që Serbia edhe më shumë ta shfaqte pakënaqësinë në lidhje me Kosovën. Serbët shfrytëzuan kompetencat kushtetuese të Presidencës së Jugosllavisë dhe krijuan gjendje të jashtëzakonshme kur edhe mori fund pozita kushtetuese e Kosovës dhe kufijtë nuk u ndryshuan, ngelën ashtu si ishin më pare. Këta kufij të imponuara për Kosovën u bënë "kufij" për nënsh-

Presheva, Bujanoci dhe Medvigja. Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2002 në këto komuna në Jug të Serbisë jetojnë 57.595 shqiptar ose 65% të popullsisë.

Ndryshmi i kufijve do të sillte zhvendosjen e popullësisë që do të ndizte zjarrin për luftëra të reja sikur në vitet 1998-1999 kur regjimi i Millosheviqit u përpoq etnikisht të spastrojë Kosovën duke dëbuar me dhunë nga trojet e tyre afër një milionë shqiptarë. Kosovarët nuk mund të harrojnë kurrë format e ndryshme të krimeve të forcave qeveritare dhe paramilitare serbe të cilët ekzekutuan mijëra burra civilë, masakruan fëmijë, gra e pleq, zhvendosën kufomat, plaçkitën dhe shkatërruan pronën, shkollat, objektet fetare etj. Të dhënat tregojnë se jetën e humbën ose u zhdukun 10.317 civilë, prej të cilëve 8.676 shqiptarë, 1.196 serbë dhe 445 romë dhe të tjerë, si dhe 3.218 pjesëtarë të formacioneve të armatosura, 2.131 pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës (FARK). Megjithë, këto krime më mizore regjimi i Millosheviqit nuk arriti të ndryshojnë kufijtë.

Shkëmbim territorësh ose korrjizim të kufijve mes Kosovës dhe Serbisë vështirë se mund të ndodhë.

Edhe pse plani shtetëror i Serbisë për zgjidhjen e çështjes së Kosovës ende nuk u bë transparent besohet se Serbia, nuk do t'i japë Kosovës asnjë pëllëm-

STUDIMI

Në kuadrin e 450 - vjetorit të ndërtimit të Xhamisë Historike të Pukës QYTET

VITI I SKËNDËRBEUT- MESAZH PËR VLERËSIMIN E TRADITAVE

Nga Xhemal Meçi*

Vendndodhja e Xhamisë Historike të Pukës

Rëndësia historike e kësaj Xhamie është e lidhur me rëndësinë e vetë Kodërgjytets. Më vonë, më 1917 e në vazhdim, u quajt Kodërhani, prej se aty mbetën hanet, kurse administrata shtetërore me garnizonin ushtarak austro-hungarez, që e ndjenin vetën ngusht mes xhamisë dhe tyrbes, zbriti në rrafshin e Qarrit t' Bajrakut (sot Nënprektura e Shtëpia e Kulturës). Që prej asaj kohe, para afro 100 vjetësh, pak nga pak qyteza u shperngul në këtë rrafsh, ku u formua qyteti i sotëm i Pukës.

Me hulumtimet e kësaj qytezeje fortesë janë marrë studiuës të ndryshëm: Frang Bardhi, Evlija Çelebi, Hekard (Hecquard, konsulli Francës, 1898), Theodor Ippen, konsull i Austro-Hungarisë, Shkodër (1896 -1903), dr. Fr. B. Nopça, Lovro Mihaqeviq (1911), dr. Milan Shufflai (Sufflay), si edhe prof. Eqrem Çabej i cili shkruan se me Pukën janë marrë studiuës të mirënjohur, që hedhin dritë mbi prejardhjen e emrit Pukë, emër të cilin e lidhin gabimisht me Epicaria etj. Ndërsa prejardhja e saj e vërtetë është Via Publika (Udhë Popullore, Publika:Pukë). Gjithashtu janë marrë me Pukën prof. dr. Selami Pulaha, prof. Injac Zamputi, prof. Kolë Luka etj.

Prof. E. Çabej thekson se: " Emrin e Pukës ,(është fjala për qytezën Koderhane -Xh. Meçi) dijetari i njohur J. G. Hahn, dikur konsull Austro-Hungarisë në Janinë, në një prej veprave të tij, e barazon gjeografikisht e gjuhësisht me emrin e vendit Epicaria ose Ad Picaria antike ("Në Pezhkve") , shënuar kështu te K. Peutingeri në hartën e tij, më parë te gjeografi e astronomi Klaud Ptolomeu i Aleksandrisë së Egjiptit, Epikaria: një stacion në rrugën, që në kohë romake prej Lezhe (Lissus) të çonte në Municipium Ulpianum, Dardani, sot Lipjan midis Shtimjes dhe Prishtinës në Kosovë. Këtë rrugë i rrihnin edhe udhëtarë e tregtarë, që shkonin prej Durrsi e Shkodër për në Prizren- Nish-Danubi Jugor deri në Odesa. Kjo qytezë (Epikaria), që prët të eksplorohet dhe të shpallet nga Bashkia Pukë, një nga pikat më interesante turistike e kësaj Bashkie.

Shufflai (Sufflay)... vuri re me të drejtë se...në shek. VI të erës sonë të historiani i Perandorit Justinian, Prokopi i Cezaresë, në veprën "Mbi "Ndërtimet" (VI)...në vend të emrit Epicarias të epokës antike shfaqet emri Pakua... në vend të një forme të drejtë Pukae (Pukë)." (PUKA DHE SHKOLLA. Shkodër, 1977, f. 6-7); por është verteturar se Puka është Kabashi antik, kurse mali sipër , në Veri, Krrabi, quhej "Monti De Puka (Mali i Pukës).

Për lashtësinë afro dymijë-vjeçare dhe vazhdimësinë e saj na dëshmon edhe studiuës Jaho Braha, ish përgjegjës i Muzeut Historik të Pukës: " Me gërmimet që kemi kryer kohët e fundit (rreth viteve 1970) në Kodërhani, aty edhe tani duken linjat e drejtimit të fortifikimi antik. Aty-



- Xhamia historike e Pukës -rrënojë, prët më në fund të rindërtohet, dhunuar më 1967;
- Pozita gjeohistorike mbi 2000-vjeçare, që prej kohës Romake;
- Kështjella rindërtohet më 1457 prej Sanxhakbeut të Prizrenit ;
- Dizdar i kështjellës caktohet prej familjes fisnike të Pukës (Kabashit) ZIU, MZIU;
- Në shekuj e vizitajnë personalitete të shquara historike:
- F. Bardhi, shek. XVII, e quan " QYTEZA E RE" apo "DUKAGJINE";
- E. Çelebi e quan " JENI KALA " (Kalaja e Re);-
- Në shek. XVII Qytezën ebanonin së bashku katolikë e myslimanë dhe harmonia mes tyre qe gjithmonë shembullore;
- Në Qytezën "DUKAGJINE", rreth viteve 1669 me rastin e 10-vjetorit të përfshirjes së Pukës në Pashallekun e Shkodrës (që ishte në formim e sipër ndërtohet Xhamia e Pukës për qytezën e lagjet fshat;
- Në anën veriore të Xhamisë në mesin e shek. XVIII u ndërdua edhe Tyrbja, së cilës nuk i mbahej mend emri, por kujtohej thjeshtë Tyrbja, edhe pse i është shërbyer deri në përfundim të Luftës I Botërore;
- NË XHAMINË E PUKËS kanë shërbyer imamë teologë të shquar, si:- MUSA Hoxhë PUKA, teolog, mbrojtës i Ymer Prizrenit, kryetarit të Lidhjes SHqiptare të Prizrenit;
- ZENEL Hoxhë MEHA, teolog, i vendosur për Pavarësi e demokraci; shpallur "Qytetar Nderi i Bashkisë Pukë";
- Elez Hoxha, përkrahës i reformave dhe i LANF, i respektuar nga Migjen, i shpallur "Qytetar Nderi i Bashkisë Pukë";
- Në Xhaminë historike të Pukës kanë falë namaz (janë lutur) kalimtarë të shquar, si: Shefqet Turgut Pasha me oficerët e tij, pushtues osman, korrik 1910;
- Ministri i Brendshëm Turk Adil Beu, mars 1912;
- Verën e 1912-ës në atë Xhami ka falë namaz disa herë Hasan Riza Pasha, i cili ka dhuruar (sadaka) 13 lira ari turke për meretim të kësaj xhamie;
- Garnizoni Austro-Hungarez vendoset larg Xhamisë, të cilën për nevoja shtarake e ktheu në magazinë 1915-1917;
- Më 1939 pushtuesit fashist kërkuan ta rindërtonin si " dhuratë nga fashizmi italian", por myftia i Pukës, H. Elez Hoxha si antifashist, që ishte, nuk pranoi .

këtu kanë dalë në dritë edhe pjesë nga faqja e murit rrethues të qytezës antike, mur i cili ka qenë ndërtuar me gurë, të lidhur pesërisht me llaç gëlqereje.

Brenda këtij fortifikimi,- vazhdon studiuës J. Brahaj,- kam zbuluar edhe copa të shumta tjegullash solene e kalipere me trashësi rreth 3 cm ashtu si edhe copa tullash rreth 4 cm trashësi, të datuara (Qendra e Kërkimeve Arkeologjike Tiranë) të shek. II - IV të erës së re." (J. Brahaj, Gjurmime arkeologjike rreth qytetit të sotëm të Pukës, kumtesë, mbajtur në Pukë, më 10. X. 1978; dorëshkrim në Muzeun Historik të Pukës).

Lidhur me familjen Ziu/Zeza J. Braha jo çdo herë është i saktë, sidomos: kur thot se Laçajt e Pukës janë "një degëzim i hershëm i Zezajve. Laçajt janë "degëzim" me Preçajt e Kabashit , Lushaj. Gjithashtu, ky autor, bazuar në të dhëna të pamjaftueshme, kryesisht gojëdhëna, konkludon mendimin e gabuar e konfliktual, kur jep shënimin : " Xhamia e Pukës është e ndërtuar... mbi themelet e kishës së Pal e Boç

Ziut." (J. Brahaj, KRONIKË E DERËS SË GJON BUZUKUT, f.19.Tiranë,2005.) Simbas kësaj sajese del se myslimanët e Pukës kanë dhunuar trojet e një kishë të krishterë mbi të cilën paskan ndërtuar një xhami.(!)

E para, në Kodërgjytet (Koderhane) nuk ka pasë kurr kishë, siç e dëshmon kujtesa historike dhe vetë Fr. Bardhi, që e viziton këtë qytezë qershor 1637, më se një shekull para se të ndërtohej xhamia.

E dyta, mjaft studiuës, kur flasin për një kishë në Pukë e kanë fjalën për Pukën vis (rrethinë) dhe jo vendbanim fshati a qyteze. Ndërsa, Puka antike dhe mesjetare është Kabashi me Kishën e Shën Palit. (Sqarime më të plota gjenden te botimi :Kabashi, Puka që në lashtësi -2, f. 35-64.Tiranë, 2008, me autor Xh. Meçi).

E treta,ka qenë traditë në krahinën e Pukës që asnjë godinë e re të mos ndërtohej mbi një truall mbetë shkret. Kështu edhe me kishat. Asnjë xhami si edhe as kishë në Pukë nuk është ndërtuar mbi troje kishash.

E katërta, Ziu-n tradita e nje në traditën Mziu: Pal Mziu e Boç Mziu për selinë e të cilëve ka mendime të ndryshme: Zezët e Pukës thonë për në Zezë. Në fshatin Mëzi, mbi Dri, thonë se Pal Mziu e Boç Mziu i kishin gurët ku uleshin e pushonin në livadhin e Kolë Bibë Dodës, . Më 1967 këto gurë me vlerë etnologjike u hodhën si "bestytini, mbeturina të së kaluemës."(!)

Në Kabash Boçen e lidhnin me toponimet -Beçme: Beçme e Eper dhe Beçme e Poshtme, një vend i bukur në afërsi të kështjellës, që përfundonte në një kullë karakteristike mbrojtëse dhe mundësi të madhe vrojtimi mbi luginën e Kabashit (Pukën antike dhe të abacisë së Shën Palit, ku shtrihej sundimi i Boçes(Boç Mziut). Ka edhe një kujtesë tjetër: vëllezërit Pal e Boç Mziu ishin vendosë forcisht në Fushblinisht, afër Sarajeve të Lekë Dukagjinit. Por, asnjë legjendë nuk i lidhë me qytezën Kodërgjytet; aq më pak me një kishë(abacinë), që e kanë pasë në Kabash.(!) Kurse, për një kishë në Kodërgjytet, me sa duket, kemi të bëjmë me një sajese të natyrës romantike. (!) (Megjithatë, botimi i J. Brahës, KRONIKË E DERËS SË GJON BUZUKUT, ka vlera me rëndësi për historinë e Pukës dhe të Shqipërisë sidomos lidhur me Gjon Buzukun - Xh. Meçi).

Toponimet (emërvendi) , mbledhë në lagjen Laçaj: Kodërgjytet, Mbasgjytetja (ana veriore e shpatit të kësaj kodre), Grykë- Gjytets dhe Fusha e Gjytets (Fusha e Pukës), janë ruajtë deri nga messhek. XX, shpjegojnë se kjo kodër ka pasë vazhdimësi dhe rëndësi historike përreth dymijë vjet.

Në periudhën Romake kjo qytezë e Kodërgjytets, ose diku afër saj, si në Fushëkuq apo në afërsi të Pezhkves, lagje e fshatit Pukë, në hartat romake shënohet Picaria apo Epicaria. Prof. Injac Zamputi shpjegonte se Picaria dhe Epicaria lidhen me një përkthim të toponimit vendas Pezhkve në Picaria latine nga administrata romake. Pra, lashtësia e kësaj qyteze vjen që prej kohëve romake apo pararomake, Ilire, dhe deri nga fund i shek. XIX që vazhdon të njihet me emrin Gjytet dhe jo Pukë. Kodërgjytet lartësohet afro 40 m mbi Prrugjytets nga ana veriore me një pjerrësi të theksuar. Nga ana jugore pjerrësia është me një kënd më të hapur, derisa nga ana juglindore formon lidhje me Koderlaçaj, por që nga ana lindore fillon e zbret përsëri deri në 30 m përbri Prrumehaj.

Pozita zotëruese me një këndpamje shumë të gjerë e kësaj kodrine është mjaft e gjetur. Për më tepër, me burime të ftohta e të shëndetshme. Rrafshi i kësaj kodrine shkon deri në më se pesëmijë m2, duke krijuar mundësinë edhe për ndërtime banesore, por me vështirësinë për ruajtjen e murit të gjatë rrethues në gjendje të mirë, siç e kanë vënë re edhe Fr. Bardhi dhe E. Çelebi me mjaft pjesë të murit të shembur.

(vijon nr. e ardhshëm)

*Studiuës - Mjeshtër i Madh

FORUM

Këshilli i Bashkisë Memaliaj nderon ish partizanin e Brigadës së XIX-t Sulmuese

Jonuz Muharrem Jahaj, “Qytetar Nderi” i Memaliajt

Këshilli Bashkiak Bashkisë së Memaliajt i ka akorduar titullin “Qytetar Nderi” veteranit të luftës Nacional Çlirimtare, Jonuz Muharrem Jahaj (pas vdekjes). Në këtë ceremoni, organizuar në 18.08.2018, morën pjesë veteranë të zones së Krahsit, këshilltarë, drejtues të pushtetit lokal, të afërm e familjarë të ish partizanit të orëve të para në zonën e Tepelenës, Jonuz Jahaj, për veprimtarinë e të cilit foli antari i këshillit bashkiak, z. Avdul Ruçi. Kryetari i Këshillit bashkiak të Memaliajt, z. Orgest Zika, përmes një atmosfere festive, certifikatën e titullit “Qytetar Nderi”, akorduar veteranit Jonuz Jahaj, ia dorzoi djalit të tij, z. Muharrem Jahaj, i cili premtoi se traditat më të mira në shërbim të atdheut do t’ua trasmetojë edhe brezave të rinj të familjes Jahaj.


Z.Avdul Ruçi ndër të tjera tha:

“Këshilli Bashkiak i Bashkisë Memaliaj me vendimin nr. 29, datë 26.04.2018, veteranit Jonuz Muharrem Jahaj, për kontributin e tij gjatë luftës Nacional Çlirimtare, i ka akorduar certifikatën e “Qytetarit të Nderit” (psas vdekjes) me këtë motivacion:

“Ka marrë pjesë në luftën Nacional Çlirimtare, në brigadën e XIX partizane dhe ka dhënë kontribut të shquar në vitet e ndërtimit të vendit”.

Veterani Jonuz Muharrem Jahaj ka lindur në 29 korrik të vitit 1922 në fshatin Levan në një familje të madhe tradicionale e patriotike, e cila përveç mikpritjes, nderit dhe respektit kishte kultivuar tek pasardhësit e vetë edhe dashurinë për atdheun. Ishte kjo parapergatitje shpirtërore që qysh herët Jonuzi iu bashkua të rinjëve në protestat e tyre kundër pushtimit të vendit nga ana e agresorëve italianë. Me formimin e formacioneve të para luftarake kundër pushtuesëve, Jonuzi u inkuadrua në çetën “Naim Frashëri” qysh në pranverën e vitit 1943, duke marrë pjesë në disa aksione luftarake, kulmi i të cilave u arrit në 25 dhe 26 qershor të vitit 1943.

Mbështetur në materialet arkivale si dhe nga dëshmitë e shkruara nga pjesmarrësit në këtë betejë, e në veçanti mbështetur në kujtimet e komandantit të çetës, Asif Dragoti, apo edhe të pjesmarrësve të tjerë si Abas



Shehu, apo Fejzo Ismaili e të tjerë, kjo betejë vazhdoi për dy ditë me radhë në

Mogila të Vasjarit e në Qafë të Miricës. Italianët, që nuk e prisnin këtë aksion, mbetën të gozhdur në vend, por edhe të tronditur nga trimëria e shqiptarëve. Ata lanë në fushë-betejë 25 ushtarë të vrarë, 15 të plagosur, ndërkohë që ranë robër në duart e luftëtarëve tanë 60 ushtarë e tre oficerë.

Në këtë përpjekje Jonuzi ishte mitralierë së bashku me një bashkëluftëtar tjetër. Duke qenë në ballë të luftës ai u plagos, e megjithë plagën e marrë nuk e lëshoi mitralozin nga dora. Nga ana luftëtarëve tanë në këtë betejë ra dëshmor Qazim Shehu (Manxhari) nga fshati Toç.

Pas kësaj beteje formacioni partizan, ku ishte inkuadruar Jonuzi, u zgjerua me pjesmarrës të tjerë, kështu që në 10 gusht të vitit 1943 në Domje të Kalivaçit u formua batalioni “Baba Abaz”.

Jonuzi, si pjesmarrës i këtij batalioni, u inkuadrua në brigade e V sul-

muese e më vonë në brigade e XIX sulmuese, ku e gjeti edhe çlirimi i vendit.

Pas çlirimit të vendit Jonuzi u khye në fshatin e tij të lindjes, në Levan e disa vite më vonë iu përgjigj thirrjes për të punuar në sektorin e naf-tës. U vendos në Patos familjarisht dhe punoi si furnitor në ndërmarren e Shpim-Shfrytëzimit, deri sa doli në pension. Ai u dallua në punë për urtësinë, këmbënguljen e korrektësinë e tij, duke i trasmetuar këto cilësi edhe tek dy djemtë e katër vajzat, tek nipërit e mbesat që sot jetojnë e punojnë me ndershmeri, duke trashguar nga babai e gjyshi i tyre, Jonuzi, amanetin që ta duan e ta nderojnë fshatin e tyre, Levanin, krahinën e tyre, Krahsin, Memaliajn e Tepelenën si dhe gjithë Atdheun tonë të dashur. Jonuz Jahaj ndërroi jetë në 10 gusht të vitit 1993 i nderuar dhe i respektuar nga të gjithë.

Nder e lavdi për veteranët e patriotët tanë!”.

HOMAZH

IKU NANË XHUMA MALEÇKA!

(Me 19 gusht 2018, iku nga jeta Nanë Xhuma Maleçka, që luftëtarëve të UÇK-së, ua shëroi plagët me lot...!)

...

Ike, Nanë Xhuma, ike
Zemren në zemra tona e le
Amanet Kosovës, historisë me
plumba

Nanë e UÇK-së, o Nanë Xhuma:

Ishe Nanë e Diellit
Ishe nanë e Luleprillit
Ishe nanë e bijve çlirimtarë
Ishe nanë e bukës, miqësisë
Sofra jote bukë, diell i mëmësisë
Plagët na i shëroje me lot
Kur më dërgoje në analiza
I thoshe doktorit:
Ky djali jem, ushrrar, Riza!
Ike, Nanë Xhuma, ike
Sot Kosova pavaresi buzëqesh
Tërë Shqipëria krenari po reshë
Lotin në sy delli s’e thanë
Kujtimin për Ty shiu s’e lanë
Nanë të pata, nanë të kam
Yt bir i dytë, unë, Riza jam!
S’mërzitet jo, jo fare
Goca jote Mona, çlirimtare:
Sa ka dritë dielli,
zani vjen me jehona:
Do jesh e gjallë, nanë Xhuma
Nanë e UÇK-së, në zemra tona!
....


Dritë pastë shpirti yt, Nanë Xhuma!
Lavdi!

...

Nanë Xhuma Maleçka, nga Tirana, plagët Luftëtarëve të UÇK-së, ua shëronte me lot,

i puthte, i donte, i uronte, i pergezonte, u kendonte, i bekonte...)

Drenice, me 20 gusht 2018, ora 4,46 minuta e mengjesit.



PROFIL

DR. LUIGJ BENUSSI, PINJOLLI I PAHARRUAR I NJË SAGE FISNIKËSH

SHPENDI TOPOLLAJ


Rruga që ka përshkruar mjekësia shqiptare është e mbushur me përpjekje e sakrificë të mëdha. Puna vetmohuese e protagonistëve të saj, nxënës humanë dhe besnikë të Hipokratit, ka bërë që ata të mbeten të nderuar përjetë në memorien e njerëzve. Është kjo arsyeja që personalisht ndihem mirë kur më bije rasti të lexoj artikuj apo monografi kushtuar jetës dhe veprës së tyre. Dhe një kënaqsi të veçantë më dha leximi i librit të profesor Lluqa Heqimit, kushtuar themeluesit të Mikrobiologjisë tonë dr. Luigj Benussit. E kush më mirë se një mjek i shquar si profesor Lluqa, do të shkruante për kolegun e tij të shquar.

E kush më mirë se një zemërmadh si ai, do të shkruante për kolegun e tij zemërmadh. E kush më mirë se një intelektual i kulturuar dhe me prirje e dashuri për letërsinë, do të shkruante për kolegun e kulturuar me prirje të hershme letrare. E kush më mirë se një demokrat me vizion perëndimor si ai, do të shkruante për kolegun e tij që kishte studiuar në shkollat më të mira të perëndimit dhe që praktikonte me guxim arritjet e atjeshme. E kush më mirë se një atdhetar si ai, do të shkruante për një shqiptar të natyralizuar i cili pas një pune të pandërprerë shkencore arriti në përfundimin se "...shqiptarët rrjedhin nga ilirët që jetojnë në trojet e tyre në pikëtakimin e popujve lindje - perëndim. Pavarësisht nga sulmet e pushtuesve, populli shqiptar e ruajti individualitetin etnik, ndihmuar edhe nga kushtet gjeografike të favorshme, por në radhë të parë nga cilësitë e karakterit të përgjithshëm" (fq 226). E vërteta është se prof. Lluqa Heqimi, shumica e njohin si mjekun e kudogjendur sportiv, dhe pak e dinë se ai është autor i suksesshëm i shumë librave, ku veç atyre profesionale, dallon "Historiku i Vokopolës" etj. dhe sidomos ky kushtuar Luigj Benussit.

Dikush ka thënë se "Jeta e njerëzve të mëdhenj filon nga çasti i vdekjes së tyre". Benussi jetoi 82 vjet dhe vdiq në vitin 1986. Sa që gjallë nuk iu ndanë peripecitë, dyshimet, cmirat, mosvlerësimet e shqetësimet, si nga ana e pushtetit komunist ashtu dhe nga meskinitet e disa prej atyre që e rrethonin. Por ai, mbeti krenar dhe i përkushtuar ndaj detyrës, pa e ulur kokën asnjëherë edhe kur mizoria e sistemit që urrente intelektualët, i arrestoi dhe burgosi dy vëllezërit, juristët e shquar Baltazarin dhe Zefin.

Autori mjaft qartë na paraqet ardhjen e Giorgio Bernardo Benussit nga Rovinjo i Istrias, në vitin 1828, si oficer në shërbim të Mustafa Pashë Bushatlliu, martesën me vajzën shkodrane Tereza Koka, pra, gjenealogjinë dhe fisnikërinë e familjes Benussi, vendosjen e tyre përfundimtare në Shkodrën që është dalluar gjithmonë për mikpritje, në qytetin që Migjeni e ka quajtur "dashnoria e shekujve". Dhe për ta bërë më bindës himnin për të, autori na e jep të plotë poezinë brilante të F. Rreshpjes "Shkodrës", ku thotë se ai qytet është arnuar me fosile mitesh dhe se shiu bibliki lan prej shekujsh gjakun e perandorive të mundura. Duke qenë se kam kaluar fëmijërinë atje, gjatë leximit, kam ndierë shumë emociione dhe shpirti më qante nga kujtimet e bukura të fëmijërisë, për ata njerëz po aq të bukur. Njihet roli i familjes në edukimin e fëmijëve, por kulturimi i tyre, natyrisht që bëhet nëpër shkollat që ata ndjekin. Një shkollë të tillë donte të hapte dhe Gjergji, siç e thërrisnin atje gjyshin e Luigjit. Po ku kishte shkollë më serioze sesa Kolegji Saverian për të cilin vetë Papa Piu i X - të shprehej se "Jeni fatbardhë që keni jezuit në Shkodër".

Këta jezuitët e krijuar si urdhër qysh nga viti 1540, kishin dhënë një ndihmesë të çmuar deri në Azinë e largët dhe tani, këtu studionin djem nga më inteligjentët, të cilët bënë emër në vitet që pasuan. I pajisur me njohuritë e nevojshme, me disa gjuhë të huaja, dhe me zellin për t'i çuar ato më tej, Luigji nis studimet e larta në Romë që dikur kishte magjepsur edhe Gëten e madh. Autori, sikur të kishte qenë vetë student i atyre viteve në Fakultetin e Mjekësisë në La Sapienza, na e jep jetën e gjallë studentore, etjen për kulturë dhe rezultate sa më të larta nga ana e Luigjit që ashtu siç e thosh dhe emri



i tij, kërkonte të bëhej "luftëtar i famshëm" në fushën e bukur të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve. Ndaj dhe nga gjithë perënditë e lashta të vendit që krijoi Remi dhe Romuli, ai adhuronte Eskulapin. Për më tepër, ai vinte në këtë shkollë të njohur në të gjithë botën, me medaljen e argjenditë që kishte fituar në Itali, qysh kur që nxënës i kolegjit Saverian. Dhe po këtu, ai me dinjitet dhe njohuri të thella në çdo fushë, fiton dashurinë dhe respektin e profesorëve, të cilët e nderonin këtë nxënës me kaq perspektivë edhe për krenarinë që tregonte për vendin nga kishte ardhur, Shqipërinë. "Ne zoti profesor, i kemi dhënë Romës Perandorë dhe Papë", janë fjalët e tij mëse domethënëse. Dhe me këtë bindje, ai pasi i kryen studimet me rezultate shumë të larta, deklamonte përmendësh para shokëve betimin e formuluar nga greku i njohur para 24 shekujsh dhe merr doktoraturën nën drejtimin e profesor Pestalozzës, por dhe kryen gjithashtu disa kurse specializimi, kthehet i plotësuar, për t'i shërbyer vendit të vet, që kishte aq shumë nevojë për njerëz si ai. E nis punën thuasë nga hiç, por i mbushur me pasion dhe entuziazëm, dhe dallohet menjëherë për vlerat e larta njerëzore dhe profesionale.

E njihje mirë rrugën e mikrobiologjisë nga kishin ecur Levenhuku, Pastëri, Lefleri, Gafki, Kohu, Rossi, Grasi, Ridi e Erliu, shpikësi i Salvarsanit, me shokë. Por ai dinte gjithashtu se përgjatë viteve edhe Shqipëria kishte shkencëtarët e vet të kësaj fushe si Refat Frashëri, Bilal Golemi e Bajram Emiri. Pa iu ndarë specializimeve, si ai në Institutin e Mjekësisë Tropicale në Belgjikë dhe për sëmundjet dermatoveneriane në spitalin "Sant Louis", së bashku me dr. Bilalin, në vitin 1939 ngritën Laboratorin Klinik Bakteriologjik. Njihen vështirësitë e panumërta që ndeshën, por duhen njohur dhe përpjekjet mbinjerëzore që ata bënë për ta vënë këtë shërbim aq të domosdoshëm, mbi baza shkencore. Pas çlirimit, pra nga viti 1945 - 1954 ai që drejtor i këtij Laboratori dhe pastaj për dhjetë vjet të tjera u caktua përgjegjës i Sektorit të vaksinave dhe preparateve diagnostike. Për dhjetë vjet të tjera ai shërbeu si pedagog në Fakultetin e Mjekësisë në U.T. dhe boton libra të vyer për ekzaminimet laboratorike dhe Leksikun e Sindromave me emra autorësh. Artikujt e tij gjenden shpesh në shtypin e specializuar të kohës, por edhe kokëçarje i shkaktohen nga ambiciozët që nuk i shihnin me sy të mirë, aftësitë, sukseset dhe cilësitë e tij njerëzore.

Koha që e tillë, që sidoqë dr. Benussi përkrahej pa rezervë nga burra të mrekullueshëm si dr. Nikolla Dush-

niku, përsëri atij ia vononin si marrjen e titullit, ashtu dhe botimin e studimit të tij aq të vlefshëm. Pra, i sillnin pengesa atij që me shpikjet dhe prodhimin e vaksinave kundër tifo - paratifo që i provonte në trupin e tij, etj. jo vetëm kishte shpëtuar aq jetë njerëzish, por dhe i kishte kursyer shtetit të varfër aq e aq dollarë. Atij që kishte udhëhequr luftën kundër sifilizit deri sa ai u zhduk tërësisht. Atij që me studimet e tij kishte arritur në përfundimin se gjaku i shqiptarëve ishte plotësisht i pastër dhe pa kurrfarë influence nga pushtimet e huaja. Atij që në krye të kryeveprës së tij shkruante: "Kushtuar nënave arbërore, që me trimërinë, moralin e patriotizmin e tyre të lartë, kanë ruajtur pastërtinë biologjike dhe etnike të popullit shqiptar", pra që na bënte të mburreshim me nënat tona dhe që na kujtonte tregimin e Marguerite Jourcenarit "Qumështi i vdekjes", ku i thuren lavde grave tona: "Po për mëmë, ama, do të desha atë çupkën e legjendës shqiptare."

atij që kishte arritur në konkluzionin se "...populli shqiptar ka mundur të ruajë krahas gjuhës, zakoneve dhe tiparet etnike që pasqyrohen në përpjestimet e shpërndarjes së grupeve të gjakut dhe ato që mund të ruhen të shenja brenda një familje." Përpiqej t'i bindte çensurët, ashtu si Xhojsi (Joyce) që i shkruante dikur botuesit konservator: "Nëse ju do të vendosni të mos e botoni librin, të jeni i sigurt që do të mbeteni përgjegjës për vonesën e civilizimit në Irlandë." Por nuk qe vetëm kjo; i ndërsejnë studentë mediokër për ta luftuar dhe për ta turpëruar, duke i vënë në një karton sa një çarçaf, një fletë - rrufe të tipit kinez.

Sikur të mos kishte mjaftuar e gjithë jeta e tij në interes të popullit, sikur të mos mjaftonte puna e palodhur në mikroskop dhe në përgatitjen e kuadrove të reja, atij, "jezuitit të dikurshëm", i kujtojnë besimin e tij katolik, me të cilin nuk i kishte prishur punë askujt. Kapitulli që po i referohemi, nga ana e autorit, jo vetëm mbetet një akt - akuzë për inkuizicionin komunist, por dhe është shkruar i tillë që të duket se je para një romani të mirëfilltë. Përgjigja e mençur e dr. Benussit mbetet proverbiale: "...Siguroj se edhe mjaft kohë më parë shkenca e vërtetë ka zhdukur nga mendja ime çdo mbeturinë të obskurantizmit mistik." Pra, sikurse shprehet Ll. Heqimi "... ai nuk thoshte asgjë për pendesën e besimit, përkundrazi, obskurantizmin mistik edhe vetë kisha katolike e kishte luftuar." Në libër, autori me të drejtë e ka parë të arsyeshme të na japë edhe "Meditimin para vdekjes" të këtij njeriu të jashtëzakonshëm, kurajoz e të pathyer, që ai u lë pasuesve, por që unë do të thosha dhe brezave të sotëm dhe atyre që do të vijnë.

Një jetë e përmbledhur në tre faqe, ku ngërthehet e shkuara, e tashmja dhe e ardhmja. Një prozë poetike që të bën të ndihesh krenar që je shqiptar, por edhe një ese që vërteton se si u ruajt i paprekur një betim i deklamuar atje buzë lumit Tiber, nga ai studenti i dikurshëm që e thërrisnin të gjithë Luigji Albaneze. Lexojmë aty një dëshirë të thjeshtë: "Kur të vdes, pasardhësve më të afërt do t'i lutem të ma mbulojnë fytyrën." Këtë dëshirë kishte shprehur plot 50 vjet më parë dhe një tjetër Luigj, Pirandello, i cili thosh: "Vdekja ime le të kalojë në heshtje - karroca mortore le të jetë ajo e më të varfërve."

Po sa të pasur shkuan këta njerëz! Në gjithë këtë monument që dr. Lluqa Heqimi i ka ngritur figurës së pavdekshme të Luigj Benussit, emrin e të cilit e mban Shërbimi ynë i Mikrobiologjisë, monument që nderon tërë aradhen e mjekëve si ai, dhe që skulptori i mirënjohur Muntaz Dhrami e ka përjetësuar me basorelievin e vendosur te spitali "Nënë Tereza", autori në krye të çdo kapitulli ka vendosur thënie të goditura, të cilat ja ngrenë vlerat artistike këtij libri. Se është ashtu sikurse thotë Bejli se "Aftësia për të cituar saktësisht është një talent shumë më i rrallë nga ç'duket." Ndaj dhe unë, duke e uruar autorin për këtë vepër kaq të arrirë, po e mbyll fjalën time me një citat të romantikut francez Alfred Vinji se: "Nderi është paqja e detyrës", me besimin se ai mjeku që i deshi aq shumë shqiptarët, dhe që bëri aq shumë për ta, do të prehet në paqe edhe për faktin se trashëgimtarët e tij do ta lartësojnë edhe më shumë lavdinë e sagës Benussi.

LIBRI

Hiqmet Gonxhja shkruan për gonxhet e prillit

Sakip Cami,
poet dhe publicist

Prof. Hiqmet Gonxhja tanimë është 90 vjeçar. Ai kadalë me një libër të plotë voluminoz me 500 faqe me të gjithë jetën e tij, me poezi, prozë, kujtime, studime etj.

Në parathënien librit me poezi, publicistikë, filozofi, mitologji, letërsi dhe fjalorthe ai shkruan: "Sidoqoftë, pena ime e vockël në dorën e një askushi, më nxiti që të mos tujem nga ballafaqimi me publikun lexues, dhe kritikën letrare, për shkak të kompleksit, që natyrshëm, bartmosha e tretë.

Unë do ti këshilloja bashkëmohatarët e mij të cilët gëzojnë shëndet normal mendor e fizik, që të guxojnë për të hedhur në letër, kujtimet, mbresat dhe frymëzimet e tyre të vyera deri në frymën e fundit.

Padyshim, në grumbullin e këtyre shkrimeve do të ketë edhe gjëra pa vlerë. Por, nga ana tjetër, ekziston mundësia, që në këto shkrime të shfaqen edhe vlera domethënëse, që mund t'i shërbejnë sadopak shoqërisë dhe thesarit të kulturës kombëtare".

Unë do të thoja që guximi i profesorit 90 vjeçar është i justifikuar dhe materia që ai paraqet është me vlera. Prof. Gonxhja nuk është askushi, siç thotë ai me modesti për vehten e tij, por gjithkushi. Ai është biri i Sami Gonxhjas, mësuesit dhe përhapësit të parë të shkollave shqipe në Dibër dhe në Shqipëri, ai është profesor i gjeodezisë shqiptare, ai është memorie që i nevojitet brezave dhe kombit.

Ai mbetet një Gonxhja prilli, një Gonxhja pranvere, ashtu siç ka mbiemrin. Poezia e tij lirike tingëllon si e shkruar dhe e përjetuar sot dhe jo 70 vite më parë. Prandaj për gazetën "Veterani" zgjodhëm pikërisht një cikël me lirika dashurie, sepse ata janë zemra dhe shpirti i poetit si dhe disa aforizma.

KUSH ËSHTË HIQMET GONXHJA

Prof. Gonxhja ka lindur në Tiranë më 21 Prill 1928, në gjirin e familjes dibrane, nga Shehri i Dibrës, e ardhur si muhaxhire ashtu si mijëra familje të tjera dibrane, në vitin e kobshëm 1913, për t'i shpëtuar genocidit serb të spastrimit etnik të ushtruar mbi shqiptarët në trojet e tyre të Maqedonisë Perëndimore e të Kosovës martire. Babaj i tij, Sami Gonxhja, një patriot i njohur për kohën kur jetoi, ishte ndër arsimtarët parë të vendit dhe kryetar i degës "Bashkimi" të Avni Rustemit për Prefekturën e Dibër - Mat. Prof. Gonxhja është pinjoll i familjeve elitare dhe patriotike dibrane. Sigurisht, këto, hollësi të origjinës së tij familjare kurrë nuk u pasqyruan në dokumenta autobiografike në kohën e regjimi monist. Në vitet 1939, z.Gonxhja kreu filloren 5-vjeçare në Shkollën e Kuqe, ndërsa në vitin 1947, diplomohet teknik ndërtimi në shkollën që në vitin 1949 do të quhet Politeknikumi "7 Nëntori". Në korrik të vitit 1953, ai diplomohet me vlerësimin "shkëlqyshëm" si inxhinier - gjeodet - hartograf, në Institutin e Lartë të Gjeodezisë. Aerofotorivelimit dhe Hartografisë në Moskë. Veprimtari shumëplanëshe e Prof. Gonxhjas është mbështetur në katër shtylla kryesore: në fushën profesionale (në zbatimin dhe drejtimin tekniko-organizative), në fushën pedagogjike dhe shkencore, si dhe në rrafshin intelektual.

AFORIZMA (Përshtatje)

Vlera e floririt njihet në zjarr
Miqësia e shokut provohet në hall.

Kur është e sëmurë zilia
Nuk ka qetësi e hajr shtëpia.

Urrejtja e papërmbajtur dhe e marrë
Kurrë nuk të shpie në rrugë të mbarë.

Forca fizike pa mençurinë dhe maturinë
Nuk të siguron suksesin, as drejtësinë.



Hiqmet Gonxhe me bashkëshorten e tij të pazëvendësueshme.



Hiqmet Gonxhja tanimë 90 vjeçar, aktualisht gjeodeti më i moshuar në Shqipëri.

Vlerat njerëzore dhe fisnikërinë
I shkatërron lakmia për pasurinë.

Namin e mirë si zotni apo pushtetar
S'ta jep paraja, dhe as posti qeveritar.

Mos u frikëso nga armiku me shpatë
Por nga "miku" lajkatar dhe gjuhë-gjatë.

Dashuria, pa asnjë pikë loti
Është, si të thuash, dashuri koti.

Me optimizëm vështirësitë i përballon
Me pesimizëm, je i humbur dhe dështon.

Nuk të edukon e frymëzon vetëm fjala
Që shpesh herë bishtnon si ngjala,
Por ai shembulli i qartë vetiak
Pa detyrim dhe pa dajak...

POEZI nga Hiqmet Gonxhja

EPITAF TE VARRI I...

Këtu prehem unë djaloshi gjuetar
Që shpend e kafshë pylli plot kam vrarë
Mallkimi i tyre jetën më shkurtoj
Prandaj, ky epitaf, pësimin tim t'u kujtoj
Dhe, pasi mësove timen histori
Mos kërko mëshirë për gjuetarin e ri.

NJË NDARJE MIZORE!...

(Kushtuar kolegëve të mi që u ndanë me të dashurat ruse në vitet 1960-1961 pas prishjes

së marrëdhënieve partiake e shtetërore ndërmjet Shqipërisë dhe ish Bashkimit Sovjetik).

Në një natë magjepsë pranverore
Unë me rusalkën¹⁾ ruse, lule bore
Të pushtuar fort qëndruam gjer sa agoi
Pa ditur se ku anija e fatit do t'na çojë
S'besojakurrë, se kyqe i funditakim
Që dikur e prisnim me mall e padurim.
Të përlotur, mallkuam këtë ndarje mizore
Të diktuar nga dasitë dhe mllfet ideore
Dëshmitarë të vetëm gjer natën në të gdhirë
Kishim yjet dhe Hënën, që na bënë sehir.
Kujtuam me mall vitet tona studentore
Kur me Tanjushkën bridhnim dorëpërdore
Në parqet e Moskës, në pistat me patina
Ku e trallisur nga muzika, vallëzonte rinia.
Qeshëm kur kujtuam, se si një herë me patina
U shemba mbi akull, për pak më krisi shpina.
...Atë "lamtumirë" – që s'ishte ëndërr e as vegim
Der'satëvdes do ta kujtoj me mallëngjim...

1) Rusalkë (rus.) –shtojzovalle, zanë.

KËRKOJ FALJE

Të lutem harroje zemërimin tim
Dhe shuplakën që të dhashë në atë takim
Harroi shprehjet dhe të sharat vulgare
Dhe sjelljen time harbute e banale
Që i rrëmbyer, gjaknxehtë, pa u thelluar
Viktimë e shpifjeve mbetsh i hutuar
Të lutem kujto dashurinë që të dhurova
Dhe poezitë plot frymëzim që për ty krijova
Për fyerjet e mia, edhe një herë, falje kërkoj
Jetën pa ty unë kurrë s'e përfytyroj
Të lutem, lere mërinë, eja te vendi që ti e di...
Dhe urrejtjen për mua ta këmbëjmë me dashuri...

LIRIA, KËNGA DHE DASHURIA

O bilbil i bukur si i larë me ar
Ti je i pari i pyllit si këngëtar
Me tingujt e ëmbël, miken e miklon
Në takimet dashurore atë e fton
Bilbili, kanarina dhe dashuria
Janë, si të thuash, vetë lumturia
Pa dashuri, liri e këngë,
jeta është e kotë
Ndryshe, më mirë të ikësh nga kjo botë.



Nr.2 Hiqmet Gonxhe (me beretë) me një grup veteranësh të Luftës Antifashiste, ish të persektuar politik (me nr. 3. M. Spahiu, kryetar i degës së O. B. V. L. të Tiranës, me nr. 1 heroi i popullit gjeneral R. Parllaku, me nr.4 P. Llubani, me nr. 5 Sh. Reçi, me nr. 6 V. Kokeri etj.)



Hiqmet Gonxhe duke bashkëbiseduar me shkrimtarin Tanush Kason, ish i përndjekur politik.

PROMOVIMI

UET-PRESS promovon “Zëra nga errësira”, Eni Vasili: Jam shokuar dhe përlotur

“Zëra nga errësira” quhet libri i gazetares Eni Vasili, që u promovua më 3 gusht në Universitetin Europian të Tiranës nën logon e UET Press dhe Institutit European Pashko, ku shtatë personazhe, disa pasardhës të familjeve të vjetra shqiptare dhe pjesa tjetër fillimisht kundërshtarë politikë të të parëve rrëfejnë ferrin e kampeve të internimit dhe burgjeve të regjimit komunist, ku kanë jetuar të gjithë për shumë vite.

Rrahman Parllaku, Eugjen Merlika, Klara Merlika, Daut Gumeni, Maks Velo, Bashkim Shehu, Simon Miraka dhe Gjon Rrethi vijnë në intervista që hedhin dritë mbi atë çfarë ka ndodhur me njeriun nën diktaturë. Këto rrëfime janë dhënë në emisionin “Studio e hapur” në News 24.

Projekti i Kujtesës është i rëndësishëm për Institutin European Pashko si një kontribut për të njohur të shkuarën, pasi njohje e saj është një kontribut për të tashmen dhe të ardhmen.

Nevila Nika në parathënien e librit shkruan se “çdo popull ka nevojë të dijë të kaluarën e tij, por në rastin e shqiptarëve kjo është një domosdoshmëri, për shkak se vitet e diktaturës komuniste kanë dëmtuar rëndë Kujtesën tonë historike duke e shtrembëruar atë për shkaqe ideologjike”.

Ndërsa gazetaria Eni Vasili, duke shpjeguar arsyet që e shtynë t’i kush-tonte hapësirë të veçantë, në emision e më pas në libër, temës së përbaljes me të shkuarën komuniste, thotë se “28 vjet prej kohës kur u rrëzua komunizmi në Shqipëri, ende nuk kemi një proces të përbaljes me të shkuarën, ende nuk ka një proces të mirëfilltë të dekomunistizimit të shoqërisë sonë”.

Vasili madje e sheh të qëllimshëm mungesën e katarsisit shoqëror kur gjykon se: “Duket sikur ka një tendencë për t’i fshehur krimet e komunizmit, së paku duke heshtur për çfarë ka ndodhur në 45 vjet diktaturë”.

Ka 28 vite që në shtypin dhe publicistikën shqiptare botohen dëshmi, biografi apo dhe romane për komunizmin, por të gjithë pranojnë se jemi ende shumë larg standardit të seri-



ozitetit dhe rëndësisë që ka në jetëtona ajo periudhë.

Në këtë kontekst ende të pasistemuar e pandriçuar, intervistat e realizuara prej Eni Vasilit, si dëshmi në vetë të parë e autentike, janë copëza historie të individëve, por mund t’i konsiderojmë fare bukur si pjesëza të një tabloje të madhe të historisë sonë kombëtare.

Thanë gjatë promovimit

HENRI ÇILI:

E mbyllim sezonin e 2017-2018 me një “gur të çmuar” siç është ky libër. Ky mision që ne nisëm, i cili është afatgjatë dhe kemi arritur në gati 25 tituj, është paksa dhe me kosto, pasi

janë tema të ndjeshme që prekin shoqërinë. Kujtoj debatet që na shoqëruan në botimet ‘Kadare’. Kur bashkëpunojmë me gazetërë të njohur, emisione dhe logo të rëndësishme, ne besoj se formësohemi më shumë në misionin e nisur në shndërrimin e komunizmit në një periudhë transparente dhe të studiuar. Ka ardhur koha që të gjithë ne të japim kontributin tonë modest. Dua të falenderoj komandantin Rrahman Parllaku, Maks Velon, Vera Bekteshin, si monumente paqësore që i bëjnë nder vendit.

RRAHMAN PARLLAKU:

Falenderoj Enin që e botoi këtë libër. Eni ka bërë një punë që duhet ta bëjnë shumë nga ne. Duhet dokumentuar këto histori për të kuptuar se çfarë ka ndodhur. Për t’u ruajtur në kujtesën e njerëzve, që është e domosdoshme, duhet që gjërat të shkruhen. Do përdor një shprehje që e kam të rëndësishme: “Çfarë është shkruar me fjalë, nuk shkulet dot me sëpatë”. Brezat duhet ta dinë se e gjitha kjo nuk është hakmarrje, por është një përpjekje që ajo së çfarë ka ndodhur të dokumentohet dhe mos të përsëritet më. Sepse ne e dimë se çfarë është hakmarrje dhe s’duhet të përsëritet.

SIMON MIRAKA:

Falenderoj Enin dhe UET që kanë marrë përsipër përfaqësimin e kësaj shtrese. Ballafaqimi me të kaluarën ka shumë rëndësi për të ditur kush

jemi dhe ku do të jemi në të ardhmen, sepse i shërbejnë konsolidimit të demokracisë. Janë objektet që do të flasin dhe do të kuptoni kush ishin kampet e internimit. Kemi nevojë që të kemi shkrime të tilla.

MAKS VELO:

Më tha (Henri) Çili se libri im ka pasur reagime të këqija. Ky është problem. Është e çuditshme forca e së keqes. Liria kishte konkurrencën e lumturisë dhe burgu të vuajtjes. Problem është që vuajtjen nuk e pranojnë asnjë dhe lumturinë e duan të gjithë, ndaj e largojnë vuajtjen. Problem është se ne si popull e duam të keqen. E duam të fortin, atë që thyen rregullat, hajdutin sepse ai që është i mirë dhe që punon, është një copë budalla. Ndaj këta libra nuk i pranojnë. Ne nuk jemi gati që të bëjmë ndryshimin tonë. Rëndësi ka që të botohen sepse falje e shohim që s’do kërkojnë.

ENI VASILI:

Fjalët më të rëndësishme i thanë ata, sepse në fakt libri për ta fliste. Ju falenderoj që pranuat intervistat me mua. Nuk gënjej kur them se jam shokuar dhe jam përlotur në çdo intervistë. Janë jetë tronditëse, të cilat e bënë t’i shkruaj në një libër, pasi shpesh intervistat e televizioneve nuk kanë kujtesë më vonë. E realizova me ET, me News 24, që i falenderoj sepse janë rrëfime që zbardhen pasi kanë tendencën që të lihen në harresë

